



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.4.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Blendi Klosi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Pandeli Majko, Lavdrim Krashi, Tritan Shehu, Greta Bardeli, Ilirjan Pendavinji, Bardhyl Kollçaku, Vangjel Dule, Grida Duma dhe Klodiana Spahiu.

Mungojnë:

Mimi Kodheli, Etilda Gjonaj, Shpëtim Idrizi, Belind Këllici, Kreshnik Çollaku dhe Petro Koçi.

Të ftuar:

Elva Margariti – Ministre e Kulturës.

Almira Xhembulla – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit.

Entela Cipa – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës.

Flonia Tashko – Avokate.

Floran Pustina – Avokat.

Alban Shanaj – Avokat.

HAPET MBLEDHJA

Blendi Klosi – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Në mungesë të kryetares, zonjës Mimi Kodheli, kam nderin sot të drejtoj këtë komision.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore do të jetë zonja Hatixhe Konomi. Më pas projektligji do të kalojë në diskutimin në parim edhe në komisionet e tjera dhe pastaj në seancë plenare.

Kemi nderin dhe kënaqësinë të kemi të ftuar dhe prezente sot në komision zonjat Elva Margariti, ministre e Kulturës, Almira Xhembulla, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, si një projektligj i përbashkët ose një punë e përbashkët e të dyja institucioneve, zonjën Entela Çipa, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, si dhe avokatët Flonia Tashko dhe kolegë të tjerë që shoqërojnë ministren.

Në bazë të praktikës së komisionit tonë, fjalën ia kalojmë drejtpërsëdrejti ministres Elva Margariti.

(Deputeti Shehu flet pa mikrofon): Kam diçka për të thënë.

Urdhëroni!

Tritan Shehu – Së pari, të uroj që po drejton mbledhjen e sotme!

Je shumë simpatik.

(Ilaritet në sallë)

Së dyti, e falënderoj zonjën ministre dhe grupin që ka ardhur, por dua të them diçka. Materiali që na është paraqitur, marrëveshja voluminoze, na ka ardhur dje pasdite vonë. Madje, jo vetëm ne si Komision i Jashtëm, por të gjithë deputetëve dhe parlamentit u është dorëzuar dje pasdite vonë. Kësisoj, unë do ta konsideroja të pamundshëm diskutimin sot të këtij projektligji, sepse realisht jam i bindur se as kolegët e tjerë nuk e kanë lexuar nga dje pasdite në ora 6 deri tani, aq më shumë ta kemi kuptuar dhe aq më shumë ta kemi konsultuar pastaj mes nesh. Sepse gjithsekush nga ne konsultohet edhe me specialistë të fushave të ndryshëm për materialet që na vijnë, se nuk mund t’i dimë ne këtu të gjitha gjërat.

Ju do të thoni se ne jemi Komisioni i Jashtëm dhe se këndvështrimi ynë nuk është si komisionet e tjera. Jam krejt dakord me ju, por këtu kemi të bëjmë me pasurinë kombëtare,

me imazhin e Shqipërisë, qoftë edhe me politikën e jashtme brenda, sepse ka të bëjë me promocionin e vendit më shumë sesa do të ishte diçka tjetër, çfarë të them unë, ndërtimi i një fabrike a i diçkaje tjetër, apo i një hidrocentrali. Këtu kemi të bëjmë me një element substancial të pasurisë kombëtare, të pozicionit tonë, të krenarisë kombëtare, të shumë gjërave që lidhen me imazhin tonë në rajon, madje do të thosha edhe më shumë se rajoni.

Prandaj unë mendoj që ne si komision duhet të jemi seriozë me veten tonë, ndërkohë që qeveria nuk është serioze me ne. Sepse vetëm një qeveri joserioze mund të sjellë një material të tillë 12 orë para mbledhjes. Kjo nuk bën vaki në asnjë vend të botës. E t'i thuhet komisionit pastaj: "Diskutoje ti, miratoje, se nesër do ta kalojmë në seancë". Kjo do të thotë të mos kesh respekt për parlamentin; kjo do të thotë të bëhemi disa shtojca të qeverisë dhe ç'të na sjellin ata, i miratojmë ne, i kalojmë.

Qoftë edhe formalisht, ju i keni numrat, mund ta miratoni, nuk kam asgjë kundër jush, okej, është puna juaj, por unë mendoj se ne duhet të mbrojmë dinjitetin tonë si deputetë dhe parlamentarizmin. Pra, kjo kërkon së paku një javë kohë të diskutohet... Se unë di që edhe komisionet e tjera përgjegjëse janë në të njëjtën situatë.

Le të bisedohet me kolegë të tjerë në qoftë se do ta shikojmë të arsyeshme, pasi gjithsekush ka pikat e veta të konsultacionit për elemente të tilla... Unë për veten time nuk jam kompetent i kësaj fushe, të mos gënjej kot. Komisione të tjera mund të thërrasin arkeologë... Kemi burime njerëzore të jashtëzakonshme, të forta në Shqipëri, që mund të thirren në komisione të tjera, jo te ne, por të paktën neve të na jepet koha ta shikojmë projektligjin, ta lexojmë, ta studiojmë, të bëjmë konsultimet tona, të cilat duhet t'i bëjmë me të tjerë dhe pastaj kemi kohë...

Pse duhet me kaq vrap? Nuk ka arsye. Asnjë parlament në botë nuk vepron kështu. Një ligj që shkon në parlamentin italian, rri me muaj e muaj të tërë derisa del... Domethënë, ne kërkojmë t'i miratojmë këto gjëra... Nga dje, pra për 12 orë, të kërkoj të nxjerr unë konkluzione për një marrëveshje të tillë, që mund të jetë shumë e mirë, unë nuk kam asnjë paragjykim, mund të jetë mjaft e mirë, por tregon një mungesë respekti nga qeveria, në radhë të parë, ndaj parlamentit.

Këto kisha. Unë nuk e votoj për këto arsye këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Blendi Klosi – Faleminderit, zoti Shehu!

Besoj se eksperiencia juaj e gjatë parlamentare ju ka vënë shpesh në situata ku ne diskutojmë në parlament, diskutojmë në komision...

Dua të jap vetëm një sqarim përpos asaj që ju thatë, natyrisht në këndvështrimin tuaj dhe, në fakt, më erdhi keq që ju e deklaruat votën kundër për vetë arsyet që ju thatë, për rëndësinë e madhe të marrëveshjes, për rëndësinë dhe nevojën shumë të madhe që ne kemi në promovimin e trashëgimisë sonë kulturore, por për mbrojtjen e saj, në radhë të parë, për promovimin, natyrisht transformimin e këtyre resurseve që ne kemi në pikat e forta turistike.

Megjithatë, do të doja vetëm të sqaroja, e thashë, nuk kam asnjë koment për atë çfarë ju thatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ndjesë edhe për fjalët që thashë!

Atëherë, në seancë plenare ky projektligj do të diskutohet në datën 19 maj. Pra, nga sot kemi një kohë shumë të gjatë që në komisionet e tjera të interesuarit të marrin pjesë dhe të diskutojnë në detaje mbi materialin.

Për sa i përket komisionit tonë dhe projektligjit, nuk është një projektligj sekret. Nga eksperiencia në administratën shtetërore di se diskutimet për këtë marrëveshje, për këtë projektligj, kanë filluar prej disa vitesh tashmë, është një punë e madhe negociatash, bashkëbisedimesh, dëgjësash publike, opinion publik i shprehur mbi detaje të kësaj marrëveshjeje... Kështu që nuk është fare një gjë që vjen fshehtëzi. Nuk ka asgjë sekrete në marrëveshje. Ka kaluar në qeveri prej disa kohësh. Vjen sot normalisht në diskutim në Komisionin e Politikës së Jashtme për të diskutuar edhe për ato që ju thatë, për vlerat që ka kjo marrëveshje në raport me një partner shumë serioz të shtetit shqiptar, me një shtet natyrisht tejet të rëndësishëm të Aleancës sonë, dhe vjen për t'u diskutuar nga pikëpamja e marrëdhënieve me jashtë që ka kjo marrëveshje dhe kjo fushë.

Prandaj, e thashë, në qoftë se ju do të keni komente, sugjerime apo edhe dëshirë për t'u njohur me detajet, komisionet e tjera paralelisht me komisionin tonë, ato që janë komisione primare në miratimin e kësaj marrëveshjeje, do të jenë në diskutim dhe do të njihen më shumë me detaje.

Prandaj, unë do t'i kërkoja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tritan Shehu – ...e kam replikë me ju, zoti drejtues.

Blendi Klosi – Patjetër.

Tritan Shehu – Sepse, e para, nuk keni pse të bëni komente pas atyre që thashë unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, një sekondë! Bëtë komente. Unë nuk kisha nuanca konspirative në ato që thashë, as akuzova ndokënd për konspiracion, as për fshehtësi. Unë thashë, për mungesë etike dhe

korrektësie ndaj parlamentit, ku dokumentet, edhe sipas Rregullores, duhet të sillen shumë kohë përpara.

Lexojeni Rregulloren e Kuvendit, ju lutem, zoti nënkryetar, shikojeni si është!

Pra, unë kërkova respektimin e Rregullores, nuk përdora asnjë term për konspiracion këtu dhe nuk e kam fare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thashë, madje, se kjo marrëveshje mund të jetë shumë e mirë. Unë nuk e di. Shumë mirë që do t'u miratuaka më vonë, pra ka kohë edhe për ne si komision ta diskutojmë pas një jave. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk thashë se nuk do ta votoj.

Unë thashë, po të kërkohet të votohet sot me nxitim në këtë mënyrë, unë nuk mund ta votoj, se nuk e njoh. Kaq thashë, pa dhënë asnjë koment konspirativ, as sekrete, as jo sekrete, nuk ka punë sekretesh në këtë mes.

Unë kaq kërkova, atë çfarë thotë Rregullorja, që materiali duhet të vijë disa ditë përpara, të na paraqitet në komision, ta shohim, ta studiojmë me qetësi, duke respektuar edhe veten tonë në këtë mënyrë, se, mbi të gjitha, nuk respektojmë veten tonë.

Qeveria vërtet nuk do të na respektojë ne, por ne duhet të respektojmë veten.

Faleminderit!

Blendi Klosi – Një sekondë, zoti Majko, të bëj vetëm një sqarim procedural!

Marrëveshja ka qenë për t'u kaluar në komision një javë më përpara, por me kërkesën e deputetëve u shty me një javë. Pra, sot jemi një javë pas një shtyrjeje të parë. Nuk e kuptoj...

(Deputeti Shehu flet pa mikrofon.)

Marrëveshja është dërguar kur është kërkuar, Doktor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ne jemi mbledhur sot një javë pasi është shtyrë nga java e kaluar, me kërkesën e deputetëve.

(Deputeti Shehu flet pa mikrofon.)

Megjithatë, fjalën e ka zoti Majko.

Ndjesë që më morët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doktor, ndjesë për atë që unë thashë, por...

Zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë mendoj se marrëveshja është shumë e rëndësishme dhe ne mund ta fillojmë sot diskutimin, por jo në sensin e debatit. Të dëgjojmë përfaqësuesit e qeverisë, të na japin një informacion të përgjithshëm, qoftë edhe në funksion të asaj që tha zoti Shehu, për të njohur projektin dhe për ta parë situatën në të gjithë pamjen e saj, të paktën në këndvështrimin e qeverisë. Pastaj, ne, si Komisioni i Jashtëm, do ta shikojmë në vazhdim.

Të dëgjojmë edhe relatoren dhe ndoshta në mbledhjen tjetër ne ta votojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blendi Klosi – Tani, ne mund të përpiqemi të gjejmë konsensusin në gjëra që janë, në fakt, të konsensuara deri tani.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik e ka miratuar dhe këtë projektvendim, sot e ka edhe komisioni përgjegjës i Ekonomisë, nesër kalon në Komisionin e Ligjeve... Pra, besoj që ne mund të kemi kërkesa, por praktika parlamentare na kërkon që ta diskutojmë dhe ta miratojmë po sot.

Megjithatë, në qoftë se nuk e do fjalën ndonjë koleg tjetër, t'ia kalojmë fjalën ministres për të prezantuar projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Alizoti.

(Deputeti Alizoti flet pa mikrofon.)

Zonja Ministre, fjala për ju.

Elva Margariti – Të nderuar deputetë,

Faleminderit për kohën tuaj sot!

Vijmë këtu pas miratimit të marrëveshjes “Për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” në Këshillin e Ministrave.

Dua të theksoj që kjo marrëveshje është nënshkruar në nëntor të vitit 2021, duke i hapur kështu një udhë të re të menaxhimit të trashëgimisë sonë përmes ngritjes së këtij fondacioni të posaçëm dhe ka kaluar më pas në të gjitha rishikimet, nëpërmjet institucioneve të Këshillit të Ministrave, për të ardhur me të gjitha rekomandimet dhe reflektimet e tyre në tekstin e marrëveshjes që e gjeni sot në parlament.

Marrëveshja, e cila merr jetë me miratimin e këtij projektligji, krijon një model menaxhimi hibrid jofitimprurës, ku shteti ka një rol tepër të rëndësishëm. Madje, më lejoni të sqaroj që në fillim se, për shkak të debateve të shumta që janë zhvilluar edhe medietikisht, pronësia e territorit dhe e aseteve të Butrintit i mbetet ministrisë si përfaqësuese e shtetit.

Mbi bazën e marrëveshjes, Butrinti do të menaxhohet nga një fondacion i posaçëm, bashkëthemeluar mes Ministrisë së Kulturës dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Fondacioni është i themeluar sipas ligjeve shqiptare të OJF-ve dhe sipas ligjit shqiptar të trashëgimisë kulturore.

Ministria e Kulturës ka dy përfaqësues në bordin drejtues, që është organi më i lartë i fondacionit, dhe kryesohet nga vetë ministri.

Krijimi i këtij fondacioni nuk ka asnjë impakt shtesë në buxhetin e shtetit.

Ministria e Kulturës vendos në arkën e përbashkët fondin aktual të Butrintit rreth 2 milionë dollarë dhe shtohet fondi prej 5 milionë dollarësh, në formë granti, nga partneri Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Në vazhdimësi ky fondacion do të vijojë të kontribuojë jo vetëm në Butrint. Çdo e ardhur e Butrintit ngel në Butrint. Organizata është jofitimprurëse.

Gjithashtu, në këtë marrëveshje për herë të parë fillojmë dhe vendosim theksin te kontributi që ky fondacion do të fillojë të derdhë në fondin e madh të kujdesit të trashëgimisë kulturore.

Qeveria shqiptare ka krijuar një tjetër instrument, që është kasa e madhe ose arka për kujdesin e trashëgimisë kulturore. Në këtë marrëveshje mes palëve është vendosur që ky fondacion jo vetëm të vazhdojë të derdhë paratë në Butrint, por të kontribuojë edhe për sitet më të vogla për simotrat e tij në territorin shqiptar.

Përfitimet e palës shtet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje janë jo vetëm investimet që do të kryhen nga donatori, siç e thashë, në formën e grantit, por gjithashtu në konservim, në restaurim dhe në asetet e reja që do të ndërtohen dhe që do t'i mbeten po njësoj Butrintit.

Marrëveshja e administrimit siguron një menaxhim të integruar të pasurisë kulturore dhe natyrore të nënzonës së trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor të Parkut Kombëtar të Butrintit, si dhe vjen në përputhje të plotë me linjat guidë të planit të menaxhimit të integruar, që, siç u tha pak më parë, ka qenë një proces i gjatë konsultimesh, miratimesh dhe ndjekjeje të të gjitha hapave që shkojnë deri tek institucionet ndërkombëtare. Flasim këtu për UNESCO-n dhe një sit Ramsar. Kështu që të tilla rekomandime janë reflektuar në të gjitha linjat guidë të planit të menaxhimit të integruar, plan ky i cili, po ashtu, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sot jemi në fazën e lidhjes së marrëveshjes për ekzekutimin e linjave guidë të planit të menaxhimit. Angazhimi, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, patjetër që shkon në qasjen e kërkimit, të konservimit dhe të hulumtimit arkeologjik.

Ministria e Kulturës është totalisht përgjegjëse për bërthamën arkeologjike të këtij parku të madh që, siç e thashë, është një park që në brendësinë e tij ka zona jo vetëm

arkeologjike, por edhe zona të mbrojtura natyrore. Patjetër, ka pasur një fokus të madh që rrjedh nga rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, si UNESCO, për të pasur angazhimin total të komunitetit lokal në këtë formë të re menaxhimi. Kjo ka qenë një nga pikat kyçe që na ka ardhur si kërkesë e ndërkombëtarëve, që për herë të parë të shtojmë, po themi, në qasjen tonë dhe në objektivat e një plani menaxhimi të integruar jo vetëm ngushtësisht fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, pra zonën arkeologjike, por të shikojmë të gjithë rathët koncentrikë që krijon ky plan për zhvillimin ekonomik.

Marrëveshja ka një afat dhjetëvjeçar me të drejtë rinovimi. Dua të theksoj këtu se rinovimi nuk është automatik në përfundimin e kësaj marrëveshjeje, por gjashtë muaj para përfundimit të afatit, palët duhet të fillojnë përsëri një proces rinegociimi që do të kalojë të gjithë procedurën si kjo që po ndjekim tani, pra të gjitha miratimet e ministrive të ndryshme të linjës që përfshihen për vendimmarrje, vendimi i Këshillit të Ministrave e më pas përsëri ratifikimi në parlament.

Detyrimi i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje në parlament vjen pasi vetë ligji i trashëgimisë kulturore vë qartazi detyrimin e kalimit në parlament për sitet- pasuri botërore. Në rastin konkret, Butrinti, siç e dimë, është një pasuri botërore, është në rang ndërkombëtar. Në '92-shin Butrinti është përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s dhe për këtë arsye ligji i trashëgimisë shpreh qartazi që marrëveshje për pasuri të tilla kalojnë për ratifikim edhe në parlament. Marrëveshja e administrimit pasqyron të drejtën e ministrisë për të mbikëqyrur totalisht mbarëvajtjen e administrimit dhe të aktiviteteve që do të kryhen nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Fondacioni i posaçëm do të administrojë pasurinë kulturore, në përputhje me destinacionin e saj të shprehur qartazi në marrëveshje dhe do të garantojë shërbime jo vetëm të hulumtimit, kërkimit, restaurimit, por edhe ato ndaj publikut, ndaj promovimit, si dhe studime dhe analiza.

Për herë të parë, në këtë marrëveshje sjellim bashkarisht jo vetëm marrëveshjen e administrimit të aseteve, por, gjithashtu, edhe një protokoll bashkëpunimi midis Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe Institutit të Arkeologjisë. Pra, i japim edhe kësaj marrëveshjeje të njëjtin tagër ligjor në ratifikimin në parlament, duke parë këtu një mundësi të mirë për të mirëcaktuar të gjitha nevojat e Institutit të Arkeologjisë, të gjitha linjat guidë, të cilat na përcaktohen nga Instituti si primare për zhvillimin e zonës arkeologjike dhe krijojmë nëpërmjet kësaj marrëveshjeje "*Butrinti Research Centre*". Pra, kthehemi tashmë me një tjetër mbështetje për kërkimin shkencor për Institutin e Arkeologjisë.

Në planin e menaxhimit për linjat guidë janë të shprehura saktë cilat janë ndërhyrjet e pritshme për dhjetëvjeçarin, por në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe në planin e biznesit që

i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje administrimi kemi shprehur qartazi edhe fondet në dispozicion për “*Butrinti Research Centre*” dhe për të gjitha aspektet e hulumtimit ose restaurimit dhe konservimit.

Kjo marrëveshje është në përputhje me nenin 12 të ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me udhëzimin “Për rregullat e monitorimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore”, dhe janë parashikuar qartë të gjitha rregullat për vlerësimin dhe monitorimin e pasurisë nga ana e ministrisë në cilësinë e pronarit shtet.

Gjithashtu, çdo muaj qershor do të bëhet një raportim mujor pranë një njësie të posaçme monitorimi, që do të ngrihet në Ministrinë e Kulturës me kalimin e kësaj marrëveshjeje, ku do të relatohet dhe ku do të raportohet për të gjithë ecurinë e këtij plani menaxhimi.

Një raportim të tillë Ministria e Kulturës e bën çdo vit edhe pranë zyrave të UNESCO-s, qendrën e trashëgimisë botërore, ku ne dorëzojmë raportin e planeve të menaxhimit, e planeve ekzekutive, të projekteve të detajuara dhe çfarëdolloj ndërhyrjeje në sitet e UNESCO-s. Këtë gjë e bëjmë jo vetëm për Butrintin, por edhe për çdo sit tjetër që është i mbrojtur nga UNESCO.

Ministria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në miradministrimin e kësaj pasurie kulturore dhe përballë UNESCO-s Ministria e Kulturës është ministria përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë sitit, që është një sit i integruar. Do të vazhdoj ta ripërsëris që nuk jemi fokusuar vetëm në bërthamën arkeologjike, por në tërësinë e ndërhyrjeve dhe të potencialeve, që nëpërmjet fondacionit mund të krijohen në zhvillime dhe në zona të tjera, në zonën ligatinore, në zonën e mbrojtur, ashtu si edhe në komunitetin përreth.

Pse është dashur një plan menaxhimi i integruar? Kjo ka qenë një nga pyetjet që është shtruar në disa prej konsultimeve publike që ne kemi bërë për hartimin e këtij plani. Kjo është jo vetëm një formë e re e nevojshme sipas kuadrit të ri ligjor, por ligji për trashëgiminë i vitit 2018 shprehet qartazi cilat janë hapat që duhen ndjekur për të arritur në projekte konkrete të detajuara. Më përpara duhet të kemi një plan menaxhimi të integruar për shkak të të gjithë natyrës së zonave të parkut dhe, gjithashtu, është një nevojë bashkëkohore që lidhet totalisht me të gjitha modelet e ndryshme që kemi në botë. Patjetër, Shqipëria duhet të ketë të njëjtën qasje për menaxhimin e këtyre siteve, sepse nuk flasim vetëm për turizëm kulturor dhe natyror, por flasim për asete, të cilat, nëse miradministrohen, sjellin në arkën e shtetit të ardhura, duke u ndarë totalisht nga koncepti i vjetër që sitet e kulturës janë vetëm asete, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje nga buxheti i shtetit.

Do të kishte qenë e lehtë sikur ne ta kishim filluar sfidën e këtyre marrëveshjeve me një sit kulturor më të vogël, me shtrirje më të vogël ose jo me mbrojtjen e UNESCO-s, por mbrojtja dhe monitorimi i UNESCO-s për ne ka qenë në vetvete një element, të cilin e kemi parë si një potencial dhe jo si një kufizim, sepse ndërveprimi dhe dialogu që kemi pasur për hartimin e planit të menaxhimit dhe të gjithë planit të biznesit dhe elementeve që kemi ndjekur në proces për të arritur deri në këtë marrëveshje, ka qenë totalisht nën rekomandimet e UNESCO-S dhe të institucioneve të tjera. Për ne, ky ka qenë një proces i gjatë, i vështirë, por shumë i nevojshëm për të krijuar nëpërmjet Butrintit një model, i cili më pas të bëhet i replikueshëm edhe në site të tjera, të cilat nuk kanë kufizimin e mbrojtjes së siteve UNESCO.

Plani i menaxhimit e shikon Parkun Kombëtar të Butrintit të kthehet në një qendër me një shumësi rathësh koncentrikë, që duhet të jetë patjetër e lidhur me zonën përreth. Janë marrë parasysh shumë elemente edhe të planeve të përgatitura në të kaluarën, sepse nuk është hera e parë që Butrinti ka një plan menaxhimi. Ai ka pasur planin e menaxhimit 2000-2005, planin e menaxhimit 2007-2018, më pas 2009, por nuk kanë pasur në fokus kryesor të gjithë pronën pasuri botërore. Kjo ka qenë një nga rekomandimet e UNESCO-s që plani i menaxhimit të ishte i integruar dhe jo vetëm i bërthamës arkeologjike. Kështu që, plani merr tashmë për herë të parë në konsideratë në mënyrë të integruar vlerën e jashtëzakonshme universale me të gjitha potencialet kulturore, natyrore mjedisore, turizëm, zhvillim ekonomik dhe kërkim shkencor.

Në terma afatgjatë, ky plan ofron një qasje të re. Ne kemi ambicien që në këtë sit trashëgimie, nëpërmjet ndërhyrjeve të rekomanduara, si në linjat guidë të planit, ashtu edhe në vet marrëveshjen e administrimit dhe planit të biznesit, të kemi për herë të parë në rajon një sit kulturor *carbon – free* ose të paktën *carbon neutral*.

Kjo është në linjë me të gjitha konventat aktuale dhe me të gjithë vizionin e zhvillimit për ruajtjen e mjedisit në mbarë botën, dhe Shqipëria i përgjigjet në këtë sfidë madhore që sjell Ministria e Kulturës po me këtë qasje në ruajtjen e mjedisit.

Duam të evitojmë sjelljen e vizitorëve në parkimin aktual. Pra, duam të shmangim totalisht transportin me automjete dhe të sjellim autobusë elektrikë, varkat, që të bëjnë aksesimin dhe në pjesët e ndryshme, duke shfrytëzuar potencialin e të gjithë parkut dhe duke shtuar vizitueshmërinë, por duke e sjellë këtë lloj qasjeje si një qasje të re në rajon. Në realizimin e kësaj ambicie madhore, Butrinti do të jetë i pari park i këtij lloji në rajon.

Së bashku me marrëveshjen e administrimit, ne kemi nënshkruar edhe protokollin e bashkëpunimit me Institutin e Arkeologjisë. Do të doja të ndalesha pak në këtë aspekt, sepse fondacioni i ri, siç e thashë, do të financojë kërkime arkeologjike përmes granteve vjetore.

Grante do të jepen jo vetëm për studime për Institutin e Arkeologjisë, por edhe për studime të tjera që lidhen me florën, faunën apo studime ekologjike në territorin e parkut. Pra, edhe në këtë rast, në asnjë moment kontributin në formë grantesh nuk e kemi parë të veçuar vetëm për zonën arkeologjike.

Konservimi i monumenteve do të mbulohet po ashtu nga financat e fondacionit. E kemi mirëdetajuar edhe këtë në planin e biznesit dhe është parashikuar një buxhet të nevojshëm vjetor për të gjitha punimet me karakter konservues dhe mirëmbajtës. Në planin e biznesit kemi parashikuar gati 3 milionë dollarë për konservim dhe 600 000 dollarë shtesë për mirëmbajtje të vazhdueshme të rrënojave arkeologjike çdo vit. Në total janë gati 4 milionë dollarë, duke përfshirë këtu edhe kontingjencën prej 10%. Kjo është një risi në menaxhimin e qëndrueshëm të siteve, sepse planifikime të tilla, të detajuara, të hartuara bashkarisht me ekspertët e fushës, për ne ka qenë një qasje e re, por që na ka çuar në një koordinim të plotë, jo vetëm në aspektin ligjor dhe kërkimor shkencor, por edhe në planifikimin e duhur të buxheteve për menaxhimin e sitit.

Menaxhimi i vizitorëve është aspekt thelbësor për qëndrueshmërinë e Butrintit. Është e vërtetë që Butrinti aktualisht është siti me më shumë vizitorë në Republikën e Shqipërisë, por ndërkohë, nga ana tjetër njohim shumë mirë sfidën e një numri të lartë vizitorësh atje ku shërbimet ose aksesueshmëria nuk i përgjigjet numrit të vizitorëve. Prandaj, pika e parë e studimit për hapat që duhet të ndiqen për fillimin e zhvillimit të kësaj marrëveshjeje administrimi është pikërisht ideja e krijimit të kësaj qendre vizitorësh, që do të ndodhet rreth 1,5 ose 2 kilometra larg nga hyrja aktuale e Butrintit, për të mos krijuar aksesueshmërinë kaotike në hyrje të sitit, por edhe duke shtuar shërbime të tjera si transporti ekologjik ose varkat elektrike, por edhe shteg-kalimet e ndryshme, duke e bërë aksesueshmërinë në sit nëpërmjet zonës së mbrojtur.

Patjetër që kemi parashikuar edhe një buxhet të nevojshëm për ngritjen e kësaj qendre vizitorësh, e cila duhet të vijë totalisht në qasjen ekologjike dhe të arkitekturës së qëndrueshme mjedisore. Është parashikuar që të fillojmë menjëherë me hartimin e projektit për këtë qendër, që, po ashtu, do të jetë një grant që do të sigurohet nga partneri ynë, Fondi Amerikan Shqiptar për Zhvillim.

Kemi studiuar disa modele të ndryshme në botë për të arritur në modelin e menaxhimit dhe në formën e fondacionit të propozuar në këtë marrëveshje. Sitet kanë qenë të shumta, që nga Stonehenge në Mbretërinë e Bashkuar, që është një nga sitet që ka ngjashmëri me Butrintin, zona arkeologjike e Pompeit në Itali, por edhe parqe kombëtare në Amerikë, që sjellin një eksperiencë të shtuar në administrimin e zonave natyrore të mbrojtura.

Siç e theksova edhe në fillim, një nga risitë e këtij plani menaxhimi është që fondi i Butrintit jo vetëm do të qëndrojë në Butrint, por fondi i Butrintit do të vazhdojë të kontribuojë në arkën e madhe të fondit të kujdesit të trashëgimisë kulturore.

Sipas modelit të financiar të paraqitur, operimi i sitit do të fillojë të krijojë teprica rreth vitit të katërt, por ne në marrëveshjen që kemi nënshkruar midis palëve, që në vitin e parë të ecurisë së këtij fondacioni do të fillojë të kontribuojë me 0,5% në kasën e madhe të fondit të trashëgimisë, më pas me 1% dhe 1,5%, për të arritur në vlerën 2%, që do të jetë një vlerë konstante, e cila do të hidhet çdo vit në fondin e kujdesit të trashëgimisë kulturore nga fondi i Butrintit.

Kemi bërë parashikimin në vlera monetare për çdo vit që nga viti i parë deri në vitin e shtatë se sa do të duhet të jetë ky fond që hidhet në kasën e madhe. Patjetër, ky është një parashikim bazë dhe në çdo moment që të ardhurat do të jenë më të larta se parashikimi i planit të biznesit, i tillë do të jetë edhe kontributi në arkën e madhe.

Gjendja aktuale e krijuar nga rruga e re për në Ksamil dhe vendkalimi i lundrës në kanalin e Vivarit, trafiku i rënduar, janë problematika që janë marrë parasysh dhe jemi në dialog me institucione të tjera për krijimin e infrastrukturës ekologjike përreth parkut. Po ashtu, qendra e vizitorëve është një nga pikat kyçe që duhet të fillojë menjëherë për të dhënë edhe impaktin e parë të kësaj zone *carbon-free*.

Doja të ndalesha pak edhe tek interesat e komuniteteve, pasi, siç e thashë, ka qenë një nga rekomandimet kryesore në dialogët e gjatë që kemi pasur, sidomos me UNESCO-n, për përfshirjen e komuniteteve në fondacionin e ri me role të ndryshme jo vetëm në mirëmbajtje dhe në kërkim shkencor për pjesën arkeologjike. Në këtë kuadër, ne kemi parë mundësinë të fillojmë të kemi një tjetër dialog edhe këtu në formë grantesh me komunitetin lokal, i cili aktualisht në sitin e Butrintin ka mbështetje nga Ministria e Kulturës me hapësira të dedikuara për këndet që ne i quajmë “Këndet SAL”, Suvenire, Art dhe Libër. Pra, në periudhat e sezonit të lartë, Ministria e Kulturës vendos në dispozicion hapësira për artizanët e zonës, ku mund të shesin produktet e tyre.

Duke krijuar qendrën e vizitorëve dhe duke studiuar përgjatë gjithë parkut pika të reja të këtyre këndeve, e çojmë më tej këtë mundësi me krijimin e këtij granti prej rreth 300 mijë dollarësh, që do të jepet nga fondacioni për komunitetet përreth, të cilat gjejnë një mundësi tjetër mbështetje dhe nuk e shikojmë më jo vetëm bërthamën arkeologjike, por të gjithë parkun natyror thjesht si një ishull të veçuar të përditshmes së tyre, por gjejmë mundësinë e ndërlikohjes për një zhvillim ekonomik të komuniteteve.

Ndoshta kjo ka qenë një pengesë e mospunësimit të planeve aktuale, që na është vënë në dukje nga ndërkombëtarët, nga UNESCO, prandaj jemi fokusuar shumë dhe kemi parashikuar madje në modelin e menaxhimit se sa duhet të jetë numri i personave, të cilët mund të angazhohen në komunitet dhe profilet e tyre. Ne kemi parashikuar të punësojmë deri në vitin e shtatë rreth 110 banorë lokalë, nga të cilët 45 prej duhet të jenë me kohë të plotë. Pra, jo vetëm që nuk kemi shkuar me anë të këtij fondacioni të realitetit të tanishëm të komunitetit të përfshirë në park, por e shtojmë akoma më tepër ndërveprimin dhe punësimin e tyre pranë Parkut Kombëtar të Butrintit.

Do të vazhdojmë të mbështesim nëpërmjet këtyre granteve për banorët vendas, jo vetëm pjesën artizanale, por duam të kemi edhe mbështetje për prodhimet lokale. Ashtu siç kemi pasur praktika të mira me agrobizneset apo fermerë të ndryshëm, do të ndihmohen për të pasur edhe etiketimin, edhe brendimin. Ideja finale është që ky fondacion të arrijë të krijojë një brendim të plotë të të gjithë parkut, ku elementet e traditës ose të prodhimit të komuniteteve lokale të kenë edhe ato etiketimin e tyre “Prodhuar në Butrint”.

Për sa i përket pyetjes “Cilat kanë qenë modelet e tjera me forma të tilla fondacionesh”, Stonehenge, është një sit që është i menaxhuar nga një organizatë jofitimprurëse *National Trust*, që është Autoriteti Kombëtar për Ruajtjen e Vendeve me Interes Historik dhe Bukuri Natyrore. Versaja po ashtu është një monument historik në pronësi të shtetit francez, që është i mbikëqyrur nga Ministria e Kulturës, njësoj si në rastin e Butrintit, me administrim dhe menaxhim financiar të pavarur. Qyteti romak i Pompeit është në pronësi të shtetit italian dhe është objekt i një konservimi afatgjatë në mbarë sitin, i mbështetur nga një korsiçium financuesish privatë, universitetesh dhe shoqëri të ndryshme, që ofrojnë një program vjetor që shkon deri edhe në programe edukimi në vazhdim.

Modelet italiane janë studiuar më gjerësisht nga ne për menaxhimin e këtyre siteve. Rasti i fondacionit si ai i muzeve të Torinos është shumë i ngjashëm me modelin e paraqitur këtu për fondacionin e menaxhimit të Butrintit për sa i përket formës së bashkëpunimit të institucioneve shtetërore, të buxhetit të shtetit dhe të donatorëve të tjerë të cilët bëhen pjesë e këtij fondacioni.

Rasti i fondacionit për menaxhimin e Butrintit është një rast i mirë për të parë se si miradministrimi i siteve të kulturës nëpërmjet donatorëve, partnerëve të ndryshëm, krijon rrathë të tjerë bashkëpunimi.

Synimi ynë është që brenda vitit të dytë të operimit të fondacionit për menaxhimin e Butrintit të vazhdojmë të kemi edhe donatorë të tjerë, sepse nëpërmjet krijimit të këtij

organizmi të këtij fondacionit bëhet akoma edhe më e lehtë qasja ndaj donatorëve, dhe pse jo, partnerëve të tjerë, që mund të kenë edhe ata rolin e tyre në bord.

Këto janë në përgjithësi pikat e rëndësishme për t'u prekur, si në aspektin ndërkombëtar, pra të qasjes ndërkombëtare të modeleve, të menaxhimit, ashtu edhe në aspektin ligjor ose të rekomandimeve të ndjekura në këto 2 vjet për të arritur në këtë model, të cilin ju prezantojmë sot.

Faleminderit!

Blendi Klosi - Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zonja Konomi si relatores e projektligjit.

Hatixhe Konomi – Faleminderit, zoti Klosi!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e hollësishëm të kësaj marrëveshjeje!

Padyshim që Butrinti mbetet aseti ynë më i madh turistik në vend dhe është destinacioni më i vizituar dhe, si i tillë, meriton menaxhimin më të mirë të mundshëm, të standardeve më të larta botërore. Në fakt, ky projektligj vjen në këtë kuadër. Ashtu sikundër e tha edhe zoti Klosi në hyrje të mbledhjes, në Komisionin e Politikës së Jashtme ne e shqyrtojmë këtë projektligj për dhënie mendimi, prandaj unë do të preferoja t'i qëndroja kësaj optike.

Optika jonë këtu është pak e ndryshme nga e komisioneve të tjera, ai i Ekonomisë apo i Kulturës. Për më tepër, relatimi juaj ishte shumë i detajuar dhe shterues, ndaj unë veçse do të bija në përsëritje në rast se do të vazhdoja të zgjatesha më tej.

Do të doja të ndalesha pak në ligjshmërinë e kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën, konkretisht me nenin 100 të saj, si dhe me nenin 17 të ligjit nr.43 të vitit 2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me pikën 5 të nenit 172 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, si dhe ligjin “Për pronat e mbrojtura” të vitit 2017. Ashtu sikurse ju e thatë, është një projektligj i hartuar sipas rekomandimeve të raportit të Shoqatës për Ruajtjen e Shpendëve dhe të Gjitarëve të Shqipërisë 2010, sipas konventës RAMSA dhe në përputhje po me agjendën për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe rekomandimeve dhe vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe organeve këshillimore të qendrës së trashëgimisë botërore në UNESCO.

Nuk do të doja të zgjatesha më tej, sepse do t'ua lë vendin diskutimeve dhe pyetjeve.

Ju falenderoj për vëmendjen dhe ju ftoj ta mbështesim projektligjin!

Faleminderit!

Blendi Klosi - Faleminderit, zonja Konomi!

Edhe një herë, duke hapur procesin e pyetjeve dhe pastaj të diskutimeve, dhe natyrisht miratimit të projektligjit, do të doja ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, doktor, por ta mbaroj mendimin, të lutem!

Dua t'i kujtoj edhe një herë komisionit se projektligji vjen si propozim në kuadër të nismës ligjore të Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenin 121 të Kushtetutës dhe nenit 17 të ligjit 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe t'i kujtoja edhe një herë komisionit që targeti ynë është në këtë aspekt, pra, nëse marrëveshja vjen në përputhje të kësaj pakete ligjore dhe të këtij kuadri ligjor. Megjithatë, deputetë janë të gjithë në të drejtën e tyre të fillojnë procesin standard parlamentar, por dua të kujtoj faktin që ne si komision e shikojmë nga ky këndvështrim projektligjin.

Fjalën e ka kërkuar zoti Shehu.

Tritan Shehu – Në fillim ne bëmë një *gentlemen agreement* midis nesh, të them të drejtën, me propozimin e zotit Majko, të cilin e quajta, "katalizatori i kompromisit" si gjithmonë, që sot të mos të votojmë, të mos ata mbyllim procesin. Dëgjuam zonjën ministre, por për arsytet që thashë në fillim fare, kur filloi mbledhja, për shkak të vonës me të cilën është paraqitur materiali, ne ta shtyjmë votimin pasi ne të kemi lexuar materialin dhe sot të vazhdojmë diskutimin. Çfarë pyetjesh mund të bëj unë kur materiali më ka ardhur në orën 19:00 të darkës, mbrëmë? Edhe të them të drejtën, edhe si roman po ta kisha lexuar gjithë këtë material kaq voluminoz, nuk mund të bëja pyetje, sepse është një çështje që i takon njerëzve më të kualifikuar.

Unë e thashë, jo vetëm thjesht nga ana profesionale, por kjo është një çështje që ka të bëjë me imazhin e Shqipërisë, me politikën e jashtme, me politikën rajonale dhe me interesat kombëtare. Është një gjë më e madhe sesa thjesht një muzeum që mund ta hapim diku apo jo? Është shumë më e madhe kjo. Këtu kemi të bëjmë me veprën kryesore të arkeologjisë, krenarinë tonë kombëtare. Pra, Komisioni i Jashtëm është më i përfshirë sesa formalisht, thjesht për të parë a është i pajtueshëm me këtë apo me atë. Se politikën e jashtme i kemi ne dhe ne mbajmë përgjegjësinë tonë.

Prandaj, unë rashë dakord me zotën Majko, i qëndrova dhe i besova absolutisht, se mendoj që është konsistent propozimi i zotit Majko dhe gjeti miratimin e të gjithëve, për ta shtyrë diskutimin javën tjetër, kur të jemi të përgatitur të gjithë. Kaq. Nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, asgjë konspirative, asgjë sekrete. Nuk kam asnjë dyshim, mund të jetë shumë i mirë materiali, por jam i papërgatitur, besoj siç janë të gjithë, se asnjë nuk është kaq gjeneri që, e mori mbrëmë në orën 17:00 materialin dhe sot është i përgatitur, përveç dikujt që e

njuh fushën hollësisht, e theksoj. Unë nuk e njoh hollësisht këtë fushë, nuk dua të gënjej, por e shikoj në prizmin e politikës së jashtme, që politikës rajonale dhe të interesave tona kombëtare.

Prandaj, unë kërkoj të zbatojmë atë *gentlemen agreement* që bëmë me zotin Majko pak më parë, për të cilën besoj se ramë të gjithë dakord, se nuk tha njeri kundër.

Blendi Klosi - Edhe një herë, zoti Shehu, natyrisht duke vlerësuar të gjithë eksperiencën tuaj parlamentare, Parlamenti funksionon në bazë të Rregullores dhe disa vendimmarrjeve shumë më të larta sesa në dëshirat e momentit, kështu që vazhdojmë procedurën për të cilën jemi mbledhur sot.

(Deputeti Tritan Shehu ndërhyr pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Shehu, ju e thatë mendimin tuaj.

Greta Bardeli – Atëherë, bie dakord me propozimin e profesorit, kur thotë se materiali i paraqitur në Komisionin e Jashtëm ka ardhur në orët e vona të pasdites, saktësisht në orën 17:00 e pak minuta, dhe nuk kemi pasur kohën e mjaftueshme, profesionale, teknike për t’u elaboruar, për të pasur një arsye argumentuese, që të jetë edhe e saktë, edhe e kuptueshme para qytetarëve, ku ndjeshmëria atje është më e lartë. Mendoj se ky material, në aspektin teknik, kërkon kohë pak më të zgjatur, por propozimi im është që, nëse ju e hidhni në votim propozimin e profesorit, do të shikojmë nëse duam të procedojmë apo jo, atëherë do të bëjmë një argumentim.

Unë kam mundur të lexoj materialin në aspektin juridik dhe kam konstatuar shumë problematika. E dëgjova me vëmendje edhe ministren dhe shikoj që këto problematika përsëri nuk i përcolli në relacionin e saj prezantues. Kështu që, pyetja e parë që lind është: a duhej të sillej ky projektligj sot në Komisionin e Jashtëm? A është brenda kompetencave të këtij komisioni? Ju pak më parë cituat nenin 121 të Kushtetutës së Republikës, ndërsa këtu te projektligji shikojmë që jeni mbështetur te neni 81, pika 1 dhe 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, tani hajde ta ndajmë pak.

Blendi Klosi – E nderuar kolege, edhe një herë po përmend arsyen pse ky projektligj ka ardhur në këtë komision, arsyeja është neni 17 i ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Meqenëse kemi një marrëveshje pak më shumë se shqiptare, ky projektligj vjen në komisionin tonë të nderuar, për të dhënë një mendim dhe një opinion.

Pa dyshim, ju keni, edhe detyrën kushtetuese, edhe politike për të bërë oponentë për projektvendimin, ju lutem shprehini ato në propozimet tuaja, në pyetjet që do të drejtoni.

(Deputetja Greta Bardeli ndërhyt pa mikrofon.)

E nderuar kolege, dhe pastaj me votën tuaj në komision dhe në Parlament.

(Deputeti Tritan Shehu ndërhyt pa mikrofon)

Dakord.

Doktor, ajo që tha zoti Majko, ishte që të bëjmë diskutimin sot, pra të plotësojmë diskutime, por ne nuk kufizojmë kohën parlamentare. Zoti Shehu, ne nuk kufizojmë kohën e diskutimit. Gjithsecili nga deputetët i di të drejtat e veta dhe nuk ka asnjë tendencë për t'u penguar, sidomos për një projektligj të tillë, i cili realisht është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. Ky nuk është një projektligj që ka të bëjë me një moment qeveritar, nuk është projekt që ka të bëjë me një ndërhyrje qeveritare, është një projektligj që ka të bëjë me një *site* të trashëgimisë kulturore, të parin *site* të mbrojtur nga UNESCO në vendin tonë, një nga perlat jo vetëm shqiptare të trashëgimisë kulturore, i cili tashmë po merr një vëmendje shumë më të madhe.

Ne jemi mbledhur mbas një javë shtyrje, kemi një javë që e kemi shtyrë diskutimin e këtij projektligji. Kështu që, ka ndonjë koleg tjetër për procedurë?

Urdhëroni, zonja Duma.

Grida Duma - Faleminderit, zoti Klosi!

Pavarësisht se qëndrimet do të jenë diverse, do të jenë me ngjyime të ndryshme, është një park i një niveli të rëndësishëm për të cilin është diskutuar goxha. Herë pas here në publik është diskutuar jo objektivisht. Unë e kuptoj pozitën tuaj, ne kemi bërë shumë politika populiste herë pas here, të cilat ndonjëherë edhe dëmtojnë në perceptim. Me këtë nuk jam duke thënë dhe nuk jam duke mbajtur një qëndrim, por nga pikëpamja procedurale, për shkak se ne mbajmë përgjegjësi politike jo vetëm zhvillimore, unë mendoj se do ta kemi, do ta gjejmë edhe dakordësinë e kolegëve, që të bëjmë disa pyetje, zoti Klosi mbi elemente të marrëveshjes. Kjo është një marrëveshje që ka nisur prej vitesh, në fakt, dhe Ministria e Kulturës përfshin edhe një fondacion amerikano-shqiptar për të cilin, unë personalisht kam respekt. Ato punë që ka marrë në menaxhim fondacioni kanë qenë punë serioze. Thënë kjo, dua të mbaj frymën konstruktive sa më shumë të mundem, sepse pasuria e përbashkët është e mira e të gjithëve, edhe individuale në fund të fundit, dhe nuk na ndan pozitë-opozitë. Megjithatë, besoj se do ta kemi dakordësinë.

E di, kur vijnë gjërat në Parlament vijnë me urgjencë, por ndoshta edhe kjo nuk është një traditë shumë e mirë, se, herë pas here, kush ka më shumë përvojë nuk është se e ndihmon gjithmonë historinë, përvoja mund të bëhet edhe për përsëritjen e së keqes jo vetëm të së mirë. Kështu që, besoj se ne do ta gjejmë dakordësinë edhe me kolegët, që të bëjmë një seancë

pyetjesh, qoftë edhe diskutimesh dhe pas këtij sqarimi të vendosim si është qëndrimi i secilit. Por ajo që dua t'ju them, është se ju jeni partia në qeverisje dhe mund të keni më shumë informacion, por mirëkuptoni edhe pozicionin tonë, që informacioni shumë i limituar dhe nuk e kemi për qëllim, absolutisht, të themi kundër për shkak të së kundërtës, e kemi për qëllim në një farë mënyre, të respektojmë pozicionin tonë përfaqësues.

Unë e kam marrë marrëveshjen, këshilltarët e grupit tonë kanë bërë aq sa kanë mundur. Sot në mëngjes, po jua them me shumë normalitet, kam marrë telefon individë të respektuar, për të cilët edhe unë do ju pyes më pas, se cilët nga individët e fushës janë pyetur, se kaq pak kemi në Shqipëri dhe pasi të kemi bërë këtë, besoj se do ta gjejmë mënyrën sesi të procedojmë.

Faleminderit, zoti Klosi!

Blendi Klosi – Shumë faleminderit, zonja Duma!

Pa dyshime dhe unë i bashkohem asaj që thatë ju.

Fondacionin që bën marrëveshje me Mistrinë e Kulturës, Fondacioni Amerikan për Zhvillimin është një institucion shumë i respektueshëm në këtë tranzicionin e vështirë shqiptar, i cili ka bërë realisht vepra shumë të rëndësishme. Unë dua realisht, edhe në këtë moment, ta përshëndes për mundësinë që i jep edhe *site-t* të Butrintit për t'u zhvilluar krejtësisht ndryshe. Natyrisht, në kuadër edhe të të gjithë Parkut Kombëtar të Butrintit, do të jetë një vlerë jashtëzakonisht e shtuar për të gjithë atë zonë dhe jo vetëm për *site-n* vetë si zonë e trashëgimisë kulturore, por për të gjithë zhvillimin e zonës, ku ne mund të krijojmë një pol shumë më të fuqishëm turistik se ajo çfarë ka prodhuar Butrinti si një destinacion turistik.

Ka koleg tjetër për procedurë?

Dakord, kalojmë në pyetje.

Për diskutim pak më vonë.

Keni pyetje drejtuar institucioneve shtetërore?

Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Faleminderit për mundësinë!

Nuk e di si është procedura në komisionin tuaj, por sipas Rregullores unë kam disa pyetje, të cilat sigurisht do t'i shoqëroj me shpjegimin pse po i bëj këto pyetje dhe cili është interesimi im.

(Zëvendëskryetari Blendi Klosi i komisionit flet pa mikrofon.)

Si të doni, se i bëj mikse edhe pyetjet edhe diskutimet.

(Zëvendëskryetari Blendi Klosi i komisionit flet pa mikrofon.)

Komisioni juaj ka marrë marrëveshjen, me sa kuptoj, dje në orën 17:00. Në fakt, më vjen shumë mirë që debati i djeshëm në Komisionin e Edukimit ka shërbyer për një gjë, sepse dua të informoj kolegët e këtij komisioni, se kolegët e komisionit tjetër kanë votuar një marrëveshje që nuk e kishin lexuar as gjysmën që ju kanë sjellë juve sot. Kështu pra, është bërë një hap përpara dhe më vjen mirë që gjithë ai “sherr”, në qoftë se doni ta quani kështu, shërbeu për diçka. Unë sigurisht, përfitoj nga rasti që kam edhe kolegë të Komisionit të Edukimit këtu, ju kërkoj ndjesë atyre kolegëve...

(Zëvendëskryetari Blendi Klosi i komisionit flet pa mikrofon.)

Po, parashtrimi i pyetjes është.

Pra, dua që këtë betejë ta vazhdojmë të gjithë së bashku dhe më vjen mirë që ju keni marrë një pjesë të marrëveshjes, edhe pse nuk keni marrë të gjithë marrëveshjen.

Pyetjet e mia janë për ministren dhe sigurisht që do të jem e pranishme në çdo komision. Pse mbahet sekret plani i biznesit? Pse mbahet sekret protokollin e bashkëpunimit? Pse mbahet sekret statusi i fondacionit? Kush është fondacioni për menaxhimin e Butrintit? Ju thoni fondacioni AADF është pjesë e këtij fondacioni, por është një fondacion tjetër, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, Kur është themeluar? Ku është statuti, akti i krijimit të këtij fondacioni? Pse nuk i vihen në dispozicion edhe këtij komisioni, por edhe komisioneve të tjera? A mund të trajtohet Butrinti si një biznes?

Nga ana tjetër, pse ndryshuat format e administrimit të Butrintit kur ishte i vetmi që nuk kishte dështuar, sepse prodhonte para? Vetëm vitin e kaluar prodhoi 1,5 milionë dollarë. Butrinti ishte i vetmi që prodhonte para. Keni parasysh, kemi pasur një vit pandemik, e të tjera, por është i pari për prodhimin e parasë. Pse shitet si sukses që ne do të marrim nga këto të ardhura 0,5% deri në 2% për fondin kulturës, kur kemi marrë 100%? Sepse të gjitha të ardhurat e Butrintit shkonin në Ministrinë e Financave dhe Ministria e Financave i alokonte te Ministria e Kulturës. Ju thoni që tani po i çojmë te fondi. Po, sepse ishit në të drejtën tuaj t’i çonit edhe më përpara te fondi i trashëgimisë kulturore, te fondi i çfarë të donit ju brenda Ministrisë së Kulturës, sepse e bëni ju buxhetin. Si mund t’u thoni shqiptarëve sot që mbasi i merrnim Butrinti 100% të të ardhurave, është sukses se do t’i marrim 0,5% deri në 2 5% të ardhurave?

Si do ta shpjegoni faktin, meqë jemi edhe në Komisionin e Jashtëm, që kjo formë e re e menaxhimit të UNESCO-s është në shkelje të Konventës së Parisit? Është në shkelje të Konventës së Parisit, konkretisht ajo që përcakton rolin e padiskutueshëm, parësor të shteteve anëtare të njohura si shtete palë në administrimin e pasurive kulturore dhe natyrore në territorin e tyre. Si i tillë, vetë ligji që e mundëson këtë gjë, sepse ju e keni mundësuar këtë

gjë me ligj, me ligjin e ndryshuar me ekspertizën e AADF-së, në vitin 2018, është antikushtetues. Megjithatë, për këtë duhet të marrim masat tona.

Thatë këtu në komision që është bërë një plan i menaxhimit të integruar të Butrintit 2020 -2030, po nga AADF-ja, dhe ky plan kishte për qëllim që e gjithë zona të trajtohej bashkërisht, të gjitha pasuritë natyrore, ndërkohë me koncesion keni dhënë vetëm zonën A. Pra, fondacionit i jepni vetëm atë pjesë për të cilën jepen bileta, ku jepen lekët, dhe nuk merr edhe pjesën tjetër të pasurisë natyrore, sepse aty janë paratë, unë e kuptoj shumë mirë. Po si e justifikoni ju këtë gjë?

Zonja Ministre, a ndiheni krenare që kompania *Prince and Pearce*, e cila ka bërë menaplanin e menaxhimit të integruar të Butrintit të paguar nga AADF-ja, nuk ka marrë dhe nuk ka përfshirë asnjë ekspert dhe studiues shqiptar? Mendoni se kjo është një gjë normale? Është qasja e duhur që duhet të kemi ndaj pasurisë sonë kombëtare, ndaj trashëgimisë sonë kulturore, që ekspertët shqiptarë, që arkeologët shqiptarë, studiuesit shqiptarët të mos përfshihen fare në planin e integruar të menaxhimit të Butrintit? A mendoni se është normale që arkeologët dhe studiuesit shqiptarë të marrin leje te një fondacion i huaj për të kërkuar historinë shqiptare? Sepse ky fondacion i huaj do të ketë menaxhimin e plotë. Në këtë rast mund të jetë amerikan, nuk e dimë pa parë letrat e fondacionit, por në rast tjetër mund të tjetër rus, grek, se i hapet rruga çdo njeriu, kalanë e Gjirokastrës ta marrë një fondacion grek, kalanë e Krujës një fondacion turk. Pra, kjo është pyetja: a është normale për ju, e gjykoni normale që ne t'ia japim një fondacioni të huaj dhe studiuesit shqiptarë t'i kërkojnë leje një fondacioni të huaj për të studiuar historinë shqiptare? Kjo është pyetja.

Pyetja tjetër, meqë jemi në Komisioni e Jashtëm, për shembull, zonja Ministre në atë gjysmë marrëveshje, në fakt, mund ta shikojnë edhe kolegët, aty nuk ka as vulë, as firmë, as firma e ministres nuk është, por është një dokument i krijuar më 30 mars nga studio "Tashko and Pustina", e tregon vetë PDF-ja, a mund të na thoni zonja Ministre, si është përzgjedhur ky fondacion? Apo është paracaktuar që do ta merrte ky? Është bërë bëhet plani që do ta merrte ky dhe e mori? Apo u hap ndonjë garë ku mund të kishte edhe fondacione të tjera që konkurruan dhe e ka fituar ky fondacion, se ne nuk e dimë se cili është, por e dini ju dhe do na i vini në dispozicion të gjitha. Kush e ka paguar studion "Tashko and Pustina"? Sepse thuhet që është bërë me një sponsorizim. A ka mundësi të na thoni se kush e bën auditimin e këtij fondacioni, se në ato pak rreshta që keni vendosur te marrëveshja, nuk kemi asnjë fjalë për auditimin, sepse nuk keni vënë dokument në dispozicion, ndaj duhen vënë dokumenti në dispozicion? Cili është bordi i drejtorëve të këtij fondacioni? Jo siç e thoni ju, por siç e kanë dokument dhe ne duhet të kemi dokumente.

Për shembull, në planin e menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit studimi i bërë nga AADF-ja, që mendohet se mund të jetë dhe pjesë e fondacionit që do ta menaxhojë, thuhet që Butrinti është vendi i një kolonie greke, dhe pyetja ime është: a kontrolloni ju dhe a do t'i kontrollojë Ministria tabelat që do të vendosen në Butrint, botimet që do të bëhen në Butrint, përdorimi Butrintit nga ky fondacion?

Ju jepni menaxhim në të gjitha format dhe jepni akses fondacionit që të marrë të gjitha lejet dhe licencat në ministri dhe një nga lejet që ju parashikoni është leja e ndërtimit. Sigurisht që në atë pak informacion që keni bërë publik, duket se një nga gjërat që do të ndërtohet është qendra e vizitorëve. Deri tani vizita ka qenë për Butrintin, si është planifikuar të jetë qendra e vizitorëve. A është planifikuar të bëhet një godinë që të bëhen foto të Butrintit brenda Butrintit dhe a ka ndërtime të tjera që i lejoni fondacionit, sepse i lejohet ta përdorë në të gjitha forma? A ka ndërtime të tjera që ju i lejoni fondacionit, sepse i lejohet ta përdorë në të gjitha format? A do të ketë aty restorante, bare e të tjerë, pra a mund të përdoret Butrinti për dasma, për vaki dhe për çdo gjë tjetër fitimprurëse që mund të mendojë fondacioni që jepni ju?

Nga ana tjetër, zonja Ministre, keni vendosur që fondacionit t'i jepni 2 milionë dola lare, të cilat janë fond aktual i Butrintit, siç e thatë edhe ju. Pra, Butrinti ka nxjerrë para, është fond aktual, të cilat i keni ju. Pse nuk i keni vënë ju në përdorim këto para, por ia transferoni një fondacioni? Ju thoni që do të marrë edhe një grant nga AADF, pra, ju thoni që AADF-ja do t'i japë grant vetes së saj për menaxhimin e fondacionit, sepse është po AADF-ja është fondacioni. Kjo më duket pak e çuditshme, megjithatë mund të jetë.

Në VKM-në që ju keni për krijimin e fondacioneve parashikohet që fondacioni që krijohet, sepse ne kemi rastin e këtij fondacioni që nuk e dimë, por do të kemi edhe raste të fondacioneve të tjera. Fondacionet që krijohen duhet të kishin ekspertizë dhe eksperiencë në menaxhimin e pasurive kulturore, pra, jo thjesht në financimin e tyre, por në menaxhimin e pasurive kulturore. Pra, mund të kesh dhënë para që ta bëjë, por problem mbetet menaxhimin e pasurive kulturore. Në dijeninë time, nuk e di fondacioni, pasi duhet të na vini në dispozicion aktet e themelimit, statutin, kush e përbën, bordin e drejtorëve e të tjerë, nëse është AADF-ja, ajo nuk ka menaxhuar ndonjëherë pasuri kulturore. AADF-ja ka financuar projekte, por nuk ka menaxhuar pasuri kulturore në Shqipëri.

Për sa i përket çmimit të biletës, thuhet se e vendosë fondacion dhe ka të drejtë ta indeksojë dhe ka të drejtë ta rrisë atë deri në 30% mbi vlerën e indeksuar, pra, Butrinti, i cili prodhon sot mjaftueshëm para edhe me atë biletë që ka, do t'i rritet çmimi i biletës dhe do të prodhojë edhe më shumë para për këtë fondacion, i cili do t'i shpenzojë, pasi do të ketë edhe

zërat e tij, mos u çudisni kur të shohim edhe shpenzime për benza dhe bileta avioni, siç na ka ndodhur me hetime të tjera parlamentare.

Zonja Ministre, a e keni ju dhe a mund ta kemi ne kontratën e sponsorizimit të lidhur me studion ligjore Tashko&Pustina?

Zonja Ministre në setin e parë të pyetjeve unë dua të mos bëj më shumë se 20 pyetje.

A gjykoni ju, zonja Ministre, se kur administrohet pasuria kombëtare, trashëgimia kulturore dhe identiteti kombëtar, Ministria e Kulturës duhet të bëjë betejë për ta administruar sa më mirë për të qenë në krye të punës?

Zonja Ministre, duke dhënë të gjithë pasurinë kulturore me koncesion, duke dhënë të gjitha sitet dhe duke hapur të gjitha rrugën për ta marrë fondacioni, si dhe duke e dhënë teatrin me PPP, për çfarë ekzistoni ju dhe për çfarë do ta paguajmë ne një Ministri Kulture dhe juve kur të gjithë menaxhimin do t'ia jepni fondacioneve, organizatave, shoqërive apo PPP-ve? Pse ne duhet të paguajmë edhe juve edhe ata?! Në qoftë se nuk e bëni dot, është shumë e thjeshtë, e shkrijmë Ministrinë e Kulturës dhe ...

Blendi Klosi - Qëndrimet tuaja politike i bëni në diskutimin tuaj.

Ina Zhupa - Ndjesë!

Zonja Ministre, a e mendon se....

Blendi Klosi - Që të mos humbasim nga fokusi, ju lutem, bëni pyetje që kanë të bëjnë me projektligjin. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ne kemi një detyrë, që është raporti i kësaj marrëveshje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, ju keni bërë shumë pyetje, të cilat, pa dyshim që nuk mund t'u japë përgjigje ministrja, si për shembull, pyetja: a janë partnerët e ministrisë luajal dhe të besueshëm, kjo është një pyetje që nuk mund të marrë përgjigje. Ju, nëse keni dyshime, rruga dihet dhe mund ta zgjidhni atje.

Ina Zhupa - Unë nuk kam dyshime, por unë nuk e di kush janë partnerët.

Blendi Klosi - Në qoftë se ju keni dyshime për luajalitetin e partnerëve keni të drejtën e komisioneve parlamentare, bëni pyetje si deputete për shumë gjera dhe për materialet që ju duhen, por ne nuk mund ta bllokojmë me këtë linjë...

Ina Zhupa - Unë mbarova.

Blendi Klosi - Kur të kemi diskutime, ju mund të flisni pa limit, por te pyetjet, ju lutem, fokusohuni, në mënyrë që edhe ne të kemi përgjigjet nga institucionet për interesin e komisioni dhe opinionit publik. Diskutimi është e drejta juaj, që mund të jetë 360 gradë

Ina Zhupa - Zoti Klosi, ju falënderoj!

Unë i mbarova pyetjet.

Blendi Klosi - Zoti Dule e ka kërkuar fjalën.

Vangjel Dule - Zoti kryesues, rreptësishtë pyetje.

Dy pyetje kam për zonjën ministre.

Pyetja e parë. A përfshin marrëveshja në fjalë administrimin e të gjithë hapësirën gjeografike që përfshinte Parku Kombëtar i Butrintit? Nëse jo, pse nuk është përfshirë e gjithë sipërfaqja e mëparshme e parkut?

Pyetja e dytë. Midis objekteve të rëndësishme të trashëgimisë në sitin e Butrinti janë edhe ato të trashëgimisë fetare. Pse nuk e keni parë të arsyeshme deri më sot, por edhe në marrëveshjen e re, për t'i përfshirë për ekspertizë, ose konsulencë komunitetet fetare, të cilat kanë një përvojë shumë më të gjatë se institucionet shtetërore, qoftë për mirëmbajtjen e tyre, por edhe për përdorimin?

Grida Duma - Zonja Ministre, a mund të kemi një planbiznes të shkruar, mbi të cilin është bazuar marrëveshja? Pra, të kuptojmë të ardhurat, investimet e të tjera. Ne jemi që gjatë kësaj kohe ta lexojmë marrëveshjen, ka një shifër 4 milionë e 985, mos gabohem, ka një shifër 6 milionë euro, thuhet diku që 8 milionë euro kanë qenë shpenzime deri në vitin 2023 dhe që këto 8 milionë euro do të paguhen nga fondacioni. Pra, duhet kuptuar qartësisht një tabelë zbritjesh dhe shumash që të saktësojmë që po kalojmë një marrëveshje me këtë investim, me këto shpenzime dhe me këto fitime. Kjo nuk ju takon vetëm juve, por i takon të gjithë eficiencës së shtetit shqiptar në të gjitha kohërat. Që ju e outsource një administrim të një pasurie tregon paaftësinë e shtetit për ta administruar. Kur e thashë parashtresën nuk nisem vetëm nga ju. Megjithatë, për ne nuk është gjë e keqe, sepse parti e djathtë jemi, nëse eficienta rritet nëpërmjet administrimit dhe nëpërmjet një fondacioni tjetër është gjë e mirë, por që eficienta rritet apo jo ne e shohim nëpërmjet një palnbiznesi që ju në marrëveshje e keni cituar shtojca, por që në shtojcën 2 nuk ka asgjë. Kjo është arsyeja pse kolegët gjithashtu vijojnë dhe bëjnë të njëjtat pyetje.

Zoti Dule bëri një pyetje, të cilën dua ta bëj edhe. A është 9400 hektarë sipërfaqja apo jo?

Pyetja tjetër. Në marrëveshje ju e keni të shkruar vetëm me një fjalë që nuk lejohet tjetërsimi, por a është theksuar, a jemi të sigurt, kjo është për efekt të minutave që do mbeten, që në 10 vjet nuk do të ketë tjetërsim të parkut të Butrintit. Par, a nuk do të ketë nga ana e administrimit asnjë devijancë të pasurisë, si sit arkeologjik, si sit religjioz e të tjerë.

Pyetja e fundit. Keni vënë një vlerë bilete 7-11 euro. A është e mjaftueshme kjo dhe a e çon kjo drejt një projekti që pas 10 vjetësh ecën me këmbët e veta pa administrim? Pra, gjithçka është nga pikëpamja e eficiencës.

Faleminderit!

Greta Bardeli - Lidhur me atë që tha pak më parë kolegia, për planin e biznesit, ku te shtojca numër e kësaj marrëveshjeje, gjatë konsultimeve shikoj që ka një mangësi të planit të biznesit. Po ashtu edhe te shtojca numër 3, te protokollin e bashkëpunimit, është i padisponueshëm. Pyetja ime lind natyrshëm, nëse do të kemi një mangësi, ose mungojnë këto dy elemente bazë të kësaj marrëveshjeje a do të jemi ne në gjendje të bëjmë një analizë teknike të përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje?

Gjatë konsultimit të kësaj marrëveshjeje përsëri kam konstatuar që bordi i drejtorëve thuhet që zgjidhet nga vetë qeveri, por nuk janë vendosur as kritere dhe as mbi çfarë bazash do të bëhet përzgjedhja e këtyre subjekteve që do të drejtojnë bordin e drejtorëve. Ka mangësi edhe tek afatet, por këto janë çështje juridike, të cilat duhen konsultuar te komisioni juridik dhe nuk e shoh të udhës që ky projektligj të kalojë këtu, në Komisionin e Jashtëm.

Ju faleminderit!

Blendi Klosi - Zonja Ministre, kam një pyetje që ka të bëjë me shqetësimin që ngritën kolegu Dule dhe zonja Duma. Pyetja ka të bëjë me raportin me Parkun Kombëtar të Butrintit dhe fondacionin si entitet publik, pra, përfitimi që do të ketë e gjithë zona e mbrojtur e Parkut Kombëtar të Butrintit, që është pa dyshim një aset kryesor dhe raporti që do të ketë ky entitet publik me Agjencinë e Zanave të Mbrojtura dhe përfitimet që do t'i vijnë të gjithë zonës nga rivlerësimi i sitit të trashëgimisë kulturore. Pra, raporti midis dy institucioneve besoj se ka një inertes shumë të madh për publikun, pasi është një vlerë e shtuar, sepse turistët që do të vizitojnë sitin e Butrintit, ose trashëgiminë kulturore të Butrintit do të kenë shumë më tepër atraksion. E gjitha që ajo thatë lidhur me rritjen e veprimtarive brenda parkut, ku duhet të përfshihen të gjitha asetet që përfaqëson ajo zonë turistike, është një benefit shumë i madh për të gjithë trashëgiminë kulturore shqiptare dhe për të shtuar të ardhurat në atë sit, që, për hir të së vërtetës, ka kaq vite që mbahet me donacione të ndryshme, të cilat janë shumë më shumë se të ardhurat që ne grumbullojmë nga biletat në zonën e trashëgimisë kulturore, kur duhet të ishte më ndryshe. Këto destinacione kanë nevojë të transformohen në industri turistike.

Unë e përshëndes këtë projektligj dhe, ju lutem, zonja Ministre, përgjigjuni pyetjeve të kolegëve, për ato që mendoni se janë të vlefshme për këtë komision dhe, pa dyshim të gjithë ne, deputetët, kemi të drejtët që t'i dërgojnë institucionit tuaj kërkesa me shkrim për informacion më të detajuar, por që në këtë komision është e pamundur që të përgjigjeni për të gjitha.

Fjala për ju, zonja Ministre.

Elva Margariti - Faleminderit të gjithëve për vëmendjen dhe pyetjet!

Po e filloj nga pyetja e fundit, sepse u bë nga disa deputetë. Në aspektin e menaxhimit të bërthamës arkeologjike në Parkun Kombëtar të Butrintit Ministria e Kulturës lidh marrëveshjen me fondacionin, sepse ministria në ligjin shqiptar ka tagër ligjor për administrimin vetëm të kësaj zone, ndërsa zona në vetvete për të gjithë implementimin e projekteve i përgjigjet planit të menaxhimit të integruar, që është një plan më i gjerë veprimi. Prandaj, ne nuk mund të lidhim marrëveshje administrimi për sa kohë që zonat e tjera janë të administruara nga zonat e mbrojtura, por kjo nuk do të thotë që fondacioni i posaçëm nuk do të lidhë marrëveshje në vazhdimësi me entitete të tjera, në rastin konkret me AKZM-në. Në linjat guidë të planit të menaxhimit janë shprehur qartë të gjitha nevojat për parkun e madh. Ministria e Kulturës e administron zonën arkeologjike me ligj. Atë zonë kompetence kemi ne me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për këtë arsye ne sjellim për ratifikim protokollin e bashkëpunimit me Institutin e Arkeologjisë, për miradministrimin e zonës arkeologjike, duke e lidhur këtë me kërkimin shkencor, duke e lidhur me ekspertizën lokale për mirëmenaxhimin e zonës arkeologjike. Gjithashtu, protokollin e bashkëpunimit është një aneks i kësaj marrëveshje të madhe administrimi, ku shprehet qartazi, siç e thashë edhe një herë, jo vetëm ekspertiza e marrë prej tyre, por edhe se cilat duhet të jenë hapat në vazhdimësi për ruajtjen, konservimin e site-t, si edhe cilat duhet të jenë hapat për krijimin e Butrinti Research Center, pra të kërkimit shkencor, cilat do të jenë restaurimet që do të kryhen, pjesën e specifikuar anën ekonomike grantet për kërkime shkencore, vlera për gërmime të reja arkeologjike vlera për mirëmbajtjen ndër vite. Pra, kjo është hartuar totalisht me Institutin e Arkeologjisë, këta janë për ne ekspertët lokalë. Ky është për ne instituti më i larët që njeh Republika e Shqipërisë për hulumtimin, mbrojtjen, restaurimin dhe konservimin e site-ve arkeologjike, kështu që ne patjetër këtë marrëveshje administrimi ne e kemi koordinuar me ta, duke lidhur aneksin e bashkëpunimit në mënyrë konkrete. Fondacioni do të vazhdojë të krijojë marrëveshje të tjera bashkëpunimi si në rastin e AKZM-së.

Patjetër, që vijmë në këtë marrëveshje administrimi dhe me elemente të tjera që i citova janë elemente ekonomike, por gjithsesi vazhdojmë i diskutojmë edhe në këtë komision, që kanë lidhje me krijimin e shtigjeve të reja për aksesimin drejt Butrintit, që lidhet me zonat e mbrojtura, aksesin nëpërmjet varkave, nëpërmjet autobusëve elektrikë, ndërhyrje të cilat nuk qëndrojnë ngushtësisht në restaurimin e dhe konservimin e zonës arkeologjike, por që prekin edhe aspektin mjedisor natyror të zonave të mbrojtura. Fondacioni edhe një herë është një fondacion i cili është krijuar midis Ministrisë së Kulturës dhe partnerit AADF. AADF-ja është partnerit strategjik që e ka fituar këtë status sipas të gjithë procedurave që dikton ligji shqiptar për statusin e partnerit strategjik dhe AADF-ja nuk është thjesht një

financues ose një donator në Republikën e Shqipëri, por zonja Zhupa, më lejoni t'ju kujtoj që AADFA-ja është dhe një e menaxhues i këtyre site-ve nëpërmjet formulave TID edhe BID, të cilat kanë kaluar edhe në Parlamentin shqiptar. AADF-ja ka rol kyç në menaxhimin e disa site-ve kulturore nëpërmjet këtyre formulave siç është qafa e pazarit të Gjirokastrës, siç kemi pazarin e Tiranës dhe procesi i përzgjedhjes së partnerit strategjik është një proces që ka kaluar në disa kolegjiume pranë Ministrisë së Kulturës. Në kuadër dhe në frymën e ligjit të trashëgimisë është ngritur Këshilli Kombëtar për Menaxhimin e Pasurive Kulturore, një këshill i cili më përpara nuk ka ekzistuar në ligjin e vjetër një organ i ir kompetent me ekspertë të ndryshëm të jashtëm nga Ministria e Kulturës, të cilët vlerësojnë jo vetëm partnerët, por projekte të ndryshme ashtu siç kanë vlerësuar edhe planin e menaxhimit. Pikë së pari, partneri strategjik duhet të provojë jo vetëm eksperiencën në fushën e kulturës të trashëgimisë kulturore por mbi të gjitha të tregojë që i përgjigjet linjave të planit të menaxhimit. E planet e menaxhimit kalojnë për miratim edhe në Këshillin Kombëtar për Menaxhimin e Pasurive Kulturore, përtej Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, ku shikohen në detaje dhe projektet kërkimore-shkencore ose të restaurimit,. Të gjitha në këto faza janë kaluar.

Nuk po trajtohet Butrinti si biznes dhe nuk po trajtohet në asnjë moment si koncesion dhe unë do të vazhdoj të qëndroj këtu derisa ky koncept të futet në kokën e çdokujt në komision, në kokën e çdo deputeti dhe të çdokujt nga publiku që na ndjek, sepse këtu nuk flasim për një biznes dhe nuk flasim për një koncesion për sa kohë flasim për një organizatë jofitimprurëse. Këtu flasim për një entitet, i cili krijohet nga shteti, ku një nga palët e administrimit vazhdon dhe Ministria e Kulturës qëndron në krye të bordit, që është organi më i lartë vendimmarrës, qëndron ministri i Kulturës.

Për sa i përket të gjithë pjesës së fondeve, edhe këtu duhet të nënvizojmë aspektin ekonomik, sepse e kuptoj që është shumë i paqartë. Aktualisht, Butrinti ka një status që lejon mbajtjen e 99% të të ardhurave të sitit në kasën e Butrintit, fonde, të cilat kalojnë edhe në vitin pasardhës. Me formulën e re, të cilën sjellim nëpërmjet fondacionit, 100% e të ardhurave të Butrintit qëndrojnë në Butrint, pra, nëse më parë 90% e të ardhurave qëndronin në kasën e Butrintit dhe 10% shkonin në arkën e shtetit, tani fondacioni do të mbajë 100% të këtyre të ardhurave dhe që vitin e parë do të fillojë të hedhë 0,5% në kasën e madhe të kulturës, jo në buxhetin e madh të shtetit, që të shpërndahet edhe në politika të tjera të nevojshme, siç flasim sot për nevojat e pandemisë apo për nevoja të tjera të krizave energjetike, por vazhdojnë të ngelen për sitet e kulturës. Pra, nuk kemi një përkeqësim të situatës ekonomike, përkundrazi shifrat janë shumë të qarta, pra nëse deri më sot ne ruanim

90% të të ardhurave të Butrintit, do të ruajmë 100% dhe do të fillojmë të kontribuojmë edhe në arkën e madhe. Pra, çdo gjë që vjen nga Butrinti, mbetet në Butrint dhe ende më shumë se fondet e mëparshme.

Pse është e nevojshme një kontribut nga ana e një donatori? Sepse kemi vënë re, jo se modeli nuk ka qenë i suksesshëm, se për nevojat që ka Butrinti për të implementuar akoma më tepër potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor, të zhvillimit ekonomik, të zhvillimit të kërkimit shkencor fondet në dispozicion nuk ishin të mjaftueshme. Prandaj, plani i biznesit sjell qartazi detajimin në hapa, ku kontributi aktual i kasës së Butrintit me rreth 2 milionë dollarësh do të ishte i pamjaftueshëm për të filluar dhe për t'i dhënë shtysën e menjëhershme këtij zhvillimi. Prandaj, aktualisht kemi një fond gjeneroz, kemi një marrëveshje granti prej 5 milionë dollarësh që u bashkëlidhet linjave guidë të planit të menaxhimit të integruar. Është plani i menaxhimit ai që cakton të gjitha etapat, të gjitha nevojat për ndërhyrje, nevojat në kohë dhe partneri strategjik i përgjigjet duke e detajuar si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në aspektin e hapave të projekteve në territor.

Për sa i përket fondacionit të krijuar midis partnerit strategjik, Fondit Amerikan për Zhvillim dhe Ministrisë së Kulturës, fondacioni i ri i posaçëm, quhet Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit dhe çdo të dhënë për këtë fondacion e gjeni në regjistrin që është një regjistër *online*, publik, ku keni të gjithë aktin e themelimit, statutin e tij, i cili është miratuar në korrik të vitit 2021. Pra, do të kishte mjaftuar një kërkim i vogël *online*, se nuk ka asgjë për të fshehur, se janë akte publike. Megjithatë, të gjitha këto do të shprehen qartazi në Komisionin e Ekonomisë. Hapat që ka ndjekur ministria për të arritur në marrëveshjen e administrimit, janë, së pari, krijimi i fondacionit me një marrëveshje bashkëpunimi, dhe kësaj radhe po i përgjigjem pyetjes suaj, ku prezenca dhe vendimmarrja për çështje të ndryshme, llojet e votimeve janë të mirëpërcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe marrëveshja e administrimit vjen në vijim të krijimit të fondacionit. Pra, pasi krijohet fondacioni i posaçëm, është ky fondacion që harton marrëveshjen e administrimit, hyn në negociata me Ministrinë e Kulturës. Prandaj shteti shqiptar ka një asistencë ligjore për të arritur në performancën më të lartë juridike, për sa kohë është një praktikë, e cila ndiqet për herë të parë në Ministrinë e Kulturës. Planin e biznesit në vetvete është i hartuar nga ekspertë të fushës, nga studio *Prince & Pearce*, që nuk është një studio e panjohur dhe vjen në bashkëpunim me *University College of London* dhe me Qendrën e Arkeologjisë. Ata kanë hartuar planin e biznesit, i cili është negociuar midis palëve. Nuk i është propozuar Ministrisë së Kulturës një plan biznesi, i cili është miratuar në parim në momentin e parë që është paraqitur. Prandaj, marrëveshja e bashkëpunimit dhe e administrimit, pasi është firmosur dhe është dakordësuar pas negocimit

midis palëve, ka kaluar në Këshillin e Ministrave. Kështu, marrëveshja që ju keni sot, ka të reflektuar të gjitha rekomandimet e ministrive të linjës, duke përfshirë këtu edhe Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, që ka pasur patjetër një rol vendimtar për të rishikuar aspekte edhe pas negociimit midis palëve. Pra, dokumenti që ne sjellim në parlament, është një dokument që ka tejkaluar çdo dakordësi dhe reflekton të gjitha elementet e biznesplanit dhe të aspekteve ligjore.

Për sa u përket tabelave dhe botimeve, Ministria e Kulturës e bën këtë në çdo sit. Nuk ka asnjë tabelë ose një botim, i cili lidhet me trashëgiminë kulturore që të mos marrë miratimet e ministrisë në këshillin e posaçëm, në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Po, është e vërtetë që kjo do të vazhdojë të bëhet edhe në Butrint, sepse asgjë nuk del jashtë tagrit ligjor të Ministrisë së Kulturës. Ashtu siç thashë, Ministria e Kulturës është pjesë e këtij fondacioni, Ministria e Kulturës është mbikëqyrësi i palës shtet. Me krijimin e këtij fondacioni, ngrihet një grup monitorimi pranë Ministrisë së Kulturës për monitorimin e të gjithë ecurisë të fondacionit dhe, përtej raportimit që ndodh në Ministrinë e Kulturës dhe në organet e tjera kompetente të qeverisë, është edhe raportimi vjetor në UNESCO.

Për sa u përket funksioneve të ndryshme që zonja Zhupa na vuri në pikëpyetje se cilat mund të jenë funksionet që mund të kryejë, jam e befasuar, gati në nivel regjisor, për të gjithë filmat që u thurën deri në aktivitete vakish apo në blerje benzash. Patjetër, këto nuk gjejnë asnjë lloj përgjigje nga ana ime, janë më tepër se qesharake, por funksionet të specifikuara në marrëveshjen e administrimit, janë funksione që, siç thamë dhe siç vuri në dukje edhe zonja Duma në pyetjen e saj, nuk mund të tjetërsohen. Zona arkeologjike është një zonë arkeologjike dhe nuk mund të tjetërsohet as në kuptimin ligjor dhe as në kuptimin funksional si një zonë tjetër. Ky është kuptimi i saktë dhe i plotë i mostjetërsimit të destinacionit të sitit. Besoj se i preka të gjitha çështjet që ishin të shumta.

Edhe një herë, meqenëse është vënë shumë theksi pse është zona A3, sepse është e vetmja zonë që me ligj, pra vetë Ministria e Kulturës me vendim të Këshillit të Ministrave administron, është kjo zonë që bëjmë marrëveshjen e administrimit dhe bashkë me marrëveshjen e administrimit të fondacionit, kemi marrëveshjen e bashkëpunimit me Institutin e Arkeologjisë që për ne është partner kyç për të ndjekur saktësisht linjat guidë të kësaj marrëveshjeje.

Blendi Klosi – Faleminderit, zonja Ministre!

Para se të hyjmë në procesin e diskutimit, doja një koment për përgjigjet tuaja, që për mua janë shteruese. Pa dyshim, gjithsecili koleg ka opinion e tij, por ajo që për mua është shumë e rëndësishme, është fjalja që ju thatë se fondacioni është 100% transparent, nuk ka

asnjë tendencë të fshihet diçka në këtë marrëveshje. Po ashtu, në 10-vjeçarin në vazhdim, ndaj të njëjtin opinion me ju, zonja Ministre, fondacioni do të jetë transparent për t'u gjykuar nga i gjithë opinioni publik, pa dyshim nga çdo deputet dhe kushdo qoftë tjetër, shoqëria civile dhe gazetarët. Besoj se kam këtë dakordësi, zonja Ministre, që fondacioni çdo gjë do ta ketë publike dhe kjo do të darovisë një histori që ne ia veshim çdo gjëje para se të ndodhë, pra i japim etiketime të caktuara.

Megjithatë, fjala është për kolegët.

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i komisionit zoti Alizoti, më pas fjalën e ka zoti Xhafaj dhe kolegët me radhë.

Tomor Alizoti – E nderuar zonja Ministre,

Unë ju dëgjova dhe, sipas këndvështrimit tim, ishin dy pyetje shumë precize: një për territorin që tha zoti Dule dhe plani i biznesi. Nuk e kam me ju, por të gjitha fjalimet, që dëgjoj në përgjithësi, janë fjalime sikur mbajnë leksione, pra janë fjalime që vetëm tregojnë teori politike. Ne këtu jemi në Komisionin e Jashtëm, i cili e prek jo direkt çështjen e Butrintit, por, meqenëse jetojmë në Shqipëri dhe Shqipëria nuk është një nga vendet nordike, por është një vend i korruptuar fatkeqësisht, ka qenë, por tani ka limite të mëdha, Ministria e Kulturës nuk është ndier fare, sepse ne në Tiranë kemi pasur një teatër, i cili ishte historia e këtij qyteti; jo me vlerën e Butrintit, por ka një histori dhe nuk ekziston. Kështu që të bësh teori dhe leksione për kulturën në Shqipëri, është pak mëkat.

Tani kemi edhe një Butrint, i cili është në dimensionin shqiptar, kombëtar, por edhe atë botëror, ashtu siç thatë edhe ju. Nuk e dimë shumë fiks, meqenëse jemi te vendi i korruptuar, nuk dimë planin e biznesit dhe nuk dimë territorin. Pra, ne, si deputetë, dhe të gjitha palët dhe, fatkeqësisht, këtë unë e them nga këndvështrimi im, pra deputetët te ne, duke përfshirë të gjitha palët, janë të rreshtuar gjithmonë çfarë u thotë partia. Këtu bëhet fjalë për një aset kombëtar. Ne duam të dimë dhe, zoti kryetar, mbase hyra pak vonë për procedurë, këto dy elemente kryesore, që në këndvështrimin tim janë themeltare: plani i biznesit, si do të trajtohen paratë, fondet, sepse është problem në Shqipëri, se për këtë diskutojmë, si dhe territori i një vendi kaq strategjik dhe me vlerë të madhe për kombin shqiptar dhe më larg botëror. Ne këto i duam.

Siç ishte edhe diskutimi i mëparshëm i zotit Majko dhe zotit Shehu, do t'ju propozoja që sot të mos e kalonim për votim këtë lloj gjëje, sepse ne si deputetë për një çështje kaq pikante dhe kaq madhore nuk mund të marrim një vendim të arsyeshëm brenda 24 orëve apo më pak se 24 orë. Dua që ta shtyjmë, sepse përvoja ndikon te njeriu për të marrë vendime dhe përvoja në këtë vend na ka treguar, fatkeqësisht, që në objektet kulturore të rëndësisë së

veçantë në Shqipëri ka afëra korruptive. Nuk akuzoj njeri për këtë gjë, por përvoja deri tani na ka treguar se, në vend të një teatri, do të kemi një kullë dhe ky është një fakt që e shikojmë. Pra, vërtet mund të ketë këndvështrime të ndryshme, por ka një realitet, ka edhe fakte. Realiteti është se teatri nuk është më dhe fakt është se aty ka një kullë.

E lashë këtë dhe po vij sërish te Butrinti. 6,2 apo 4,9; plan biznesi, apo jo plan biznesi, a përfshihet i gjithë territori, siç tha zoti Dule? Ne këto nuk po i marrim, po kalojmë gati orën në komision, po dëgjojmë, por me gjithë respektin, se unë nuk fyej njeri, nuk kuptova gjë. Dua ta dëgjoj edhe një herë dhe e dua të saktë. Kur do ta kemi këtu të shkruar planin e biznesit. Nuk ka me të thënë, se shteti nuk bëhet më të thënë, se ju jeni edhe djalë i ri; shteti bëhet me letra dhe me vepra. Ku janë këto plane biznesi që unë të ngre dorën, sepse bëhet fjalë për një objekt të rëndësishëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani ju mos u merrni me sistemin e dëgjimit tim. Ju jeni shumë i ri, por a dëgjoj apo nuk dëgjoj unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur i drejtohem ministres, i drejtohem ministres, ju nuk keni pse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë tani po flas dhe, meqenëse i respektoj të gjithë këtu, sepse ne jemi ndër komisionet model këtu, unë i kam urryer gjithmonë njerëzit që hidhen, mbaje vendin tënd; ja ku është zonja e nderuar, sharmante. Kështu që këto janë pyetjet e mia.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Etjen Xhafaj – Faleminderit!

Duke falënderuar zonjën ministre dhe zëvendëskryetarin, zotin Alizoti, besoj se paragjykimi se korrupsioni është vetëm këtu, nuk është as në Suedi dhe ky miti që kemi krijuar për luftën ndaj korrupsionit se u fituaka nga një njeri i përveçëm, është një mit që nuk është provuar deri më sot në historinë e njerëzimit, pavarësisht se jam i bindur që ju do të donit ta provonit.

Dua të vlerësoj se për sa i përket objektit, subjektit, sigurisht, qëllimit të këtij komisioni, ky projektligj sillet këtu për të parë nëse është në përputhje me ato që janë marrëveshjet dhe i gjithë kuadri legjislativ i kaluar në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar me të gjitha vendet e tjera të botës për sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara ndaj Shqipërisë, sigurisht edhe për sa i përket partnerit....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket objektit të këtij komisioni, në dijeninë time nga të gjitha marrëveshjet e mëparshme që kanë kaluar në këtë komision, pavarësisht përbërjes së tij, partneri në fjalë është partner i besueshëm, modeli i përdorur është një model, i cili përdoret rëndom në të gjitha rastet e tilla, ku krijohet një etnitet i veçantë financiar për sa i përket menaxhimit të një objekti të veçantë, duke mos i përfshirë të gjitha brenda një fondacioni, i cili, në thelb, është jofitimprurës. *AlbanianAmerican Development Fund* është një nga ata partnerë që ka më shumë se 25 vjet që bashkëpunon me shtetin shqiptar, pavarësisht se kush është në pushtet në Shqipëri dhe kanë një rekord të provuar suksesi në të gjitha fushat.

Për sa i përket aspektit teknik, besoj se ka komisione të posaçme të parlamentit dhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të cilat merren me këtë. Në qoftë se do të duhet këtu të ndalojmë në çdo detaj të çdo marrëveshjeje dhe të pyesim pastaj se cili është çdo partner i çdo marrëveshjeje, kjo nuk përbërën objektin e këtij komisioni, përbën më pas një qëndresë politike, që, në fakt, nuk është objektivi në bazë të asaj Rregulloreje që ju e keni marrë me vete.

Politika e jashtme ka të bëjë me një lidhje të drejtpërdrejtë me ata që janë partnerët tanë ndërkombëtarë. Në këtë rast specifik është një etnitet i veçantë që është krijuar për menaxhimin e një objekti të rëndësisë strategjike për sa i përket turizmit, sigurisht, edhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri, për të cilin ne mund të kemi të gjitha preferencat tona me kë do të donin të ishte, por është marrë ky vendim. Për sa i përket objektivit të këtij komisioni, është në përputhje të plotë me legjislacionin, me ato që janë të dhëna publike dhe rregullat e parlamentit. Unë do të doja shumë që të fokusoheshim tek ai që është objekti i komisionit, pa paragjykuar asnjë nga çështjet që u sollën këtu, pa paragjykuar se, duke qenë se është Komisioni i Politikës së Jashtme, nuk mund të paragjykojmë një partner apo një tjetër, nuk mund të themi kalaja greke apo kjo histori e tjetra. Ne bashkëpunojmë me të gjithë dhe kemi partnerë strategjikë, se jemi në një rajon strategjik dhe për këtë objektiv bashkëpunojmë qoftë me ata, si kolegu që sapo la komisionit, që janë të minoritetit grek apo edhe me Greqinë, si dhe me të gjithë partnerët e tjerë dhe nuk mund ta paragjykojmë këtë marrëdhënie.

Për sa u përket interesave kombëtare, besoj se ky projekt në vetvete përbën një avancim, duke qenë se në eksperiencën tonë, të paktën në menaxhimin e këtyre 30 vjetëve të fundit, ato që janë objekte të kësaj rëndësie, që janë menaxhuar nëpërmjet etnitetëve shtetërore, nuk kanë avancuar me atë shpejtësi, që do të donim të shikonim ne, dhe kolegu Klosi, që ka qenë ministër, mund ta verifikojë dhe ta vërtetojë këtë. Besoj se është koha të prodhojmë një model të ri për zhvillimin e turizmit në Butrint dhe, sigurisht, në të gjithë

Jugun e Shqipërisë. Për sa u përket atyre që janë prioritete të këtij komisioni, ne duhet ta votojmë njëzëri.

Faleminderit!

Blendi Klosi – A ka kolegë tjetër për të diskutuar? Më pas, meqenëse fjalën e ka zonja Zhupa, e cila mbase ka edhe diskutimin më të gjatë, në përputhje me atë që thanë kolegët, t'i drejtohem institucionit për më shumë informacione, edhe me konsensusin e të dy krahëve. Zoti Shehu, e kam për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, meqenëse zoti Shehu e ka kërkuar që në fillim.

Me diskutimin e zonjës Zhupa, natyrisht, dhe me ndërhyrjen e ministres ne e mbyllim edhe procesin tjetër të diskutimeve në rutinën parlamentare të miratimit të projektligjit. Pa dyshim, kolegët mund të bëjnë kërkesa për më shumë informacion pranë sekretarisë së komisionit, të cilat ua transmetojnë institucioneve dhe procesin e votimit e lëmë në një moment të dytë, pasi të jemi edhe më shumë. Unë besoj se është nga ato marrëveshje që nuk ka asgjë për të fshehur dhe vetë partneriteti me një institucion prestigjioz, përfaqësues të aleatit tonë më të madh, na bën të paktën të kemi bindje të plotë, të paktën krahu ynë i kësaj sallë, që nuk kemi asgjë për të fshehur dhe nuk mund ta mendojmë se aty ka diçka të fshehtë. Proceset për menaxhimin dhe për mënyrën se si mendojmë janë pjesë të ndarjeve tona politike. Ne mendojmë se kjo është një rrugë e drejtë. Pa dyshim, kolegët kanë një opinion tjetër, por do të kërkoja nga ky komision, ku të paktën, ashtu siç e tha zoti Alizoti, kemi dakordësuar për shumicën e gjërave dhe kemi gjetur gjuhën për ta mbajmë një komision model dhe mos lejonit sot, që mungon edhe kryetarja, të kemi një divergjencë. Jemi në praktikat normale parlamentare, të mbarojnë diskutimet. Informacionet mund t'i kërkonit edhe ju, mund t'i kërkonit të çfarëdollojshme dhe në një moment të dytë të shkojmë në një proces votimi, ku unë mendoj se do të duhet të jemi me konsensus, por pa dyshim që nuk është një moment që t'ia kërkoj opozitës, opozita ka qëndrimet e saj dhe për këtë jeni qind për qind në të drejtën tuaj.

Kështu që fjalën e ka zonja Zhupa, ndërhyjnë ministrja dhe kërkojnë konsensusin e kolegëve që procesin e votimit ta lëmë në një proces të caktuar dhe u kërkojmë kolegëve të depozitojnë në sekretari pyetjet, por dhe ministres, që besoj se ka thënë disa herë, por asgjë të keqe nuk ka nga përsëritja e mesazheve, se është një proces transparent dhe nuk kemi asgjë për të fshehur, qoftë sot dhe qoftë në 10 vjetët e ardhshëm të jetës së këtij fondacion, se ju, si deputete e Sarandës, zonja Zhupa, besoj se e dini që ai qytet dhe ajo zonë jeton me Butrintin.

Ina Zhupa – Faleminderit, zoti Klosi!

Fillimisht, dua t'ju falënderoj, sepse në këta 6 muaj nuk më ka qëlluar një komision kaq i qetë dhe një drejtim kaq profesional, sepse, zoti Klosi, me keqardhje, kolegët e mi të Komisionit për Edukimin dhe kanë votuar një marrëveshje sekrete, kanë votuar pa parë marrëveshjen, vetëm se besonin se kështu ia bënin shërbimin më mirë ministres dhe Edi Ramës, kanë votuar pa pasur edhe gjysmën e materialit që ju keni sot, sepse kishin arrogancën e numrave. Debati dhe për ta kthyer në hullinë e procedurës, shërbeu për një gjë në fund të ditës: ju të merrnit një pjesë të marrëveshjes. Sigurisht që beteja vazhdon, sigurisht që, si deputete e Sarandës, nuk më shkon ndërmend të tërhiqem nga kjo betejë, sigurisht që do t'i ndjek të gjithë hapat, aq sa më lejon ligji, në bashkëpunim me ekspertët shqiptarë dhe me shoqërinë civile, pra gjithçka për të ndaluar marrjen e Butrintit me koncesion.

Siç e dini, “djalli fshihet te detajet”. Plani i biznesit që ju e mbani sekret, protokollin e bashkëpunimit që ju vazhdoni ta mbani sekret, deri dhe kishit sekrete edhe pjesë të marrëveshjes, sot e çkoduat një pjesë, por keni mbajtur pjesën e parave, aty ku fshihet djalli, te plani i biznesit, te protokollin e bashkëpunimit.

Më erdhi shumë keq, e kam vënë re edhe në komisionet e tjera, që ministrja, sa herë vjen në komision, mëson një gjë të re, që nuk e ka ditur. Më ka ndodhur disa herë në Komisionin e Edukimit, fatmirësisht e kanë vënë re edhe mediet, edhe sot tha se mund t'i gjejnë *online* vendimet e gjykatës. Në fakt, jo, në bazë të zbatimit të vendimit të Konventës Europiane, vendimet e gjykatës nuk publikohen më, zonja Ministre, dhe ne nuk mund t'i gjejmë, përveçse po të jemi palë e interesuar, pjesë e procesit; për këtë mund të konsultoheni edhe me juristët që keni në krah.

Pyetja ime pa përgjigje (disa nga pyetjet janë pa përgjigje) është: pse nuk i përfshitë ekspertët shqiptarë, zonja Ministre, në planin e menaxhimit të integruar të Butrintit? I harruat, jemi në Komisionin e Jashtëm, i harruat ekspertët shqiptarë, arkeologët shqiptarë.

Pyetja ime që harruat përsëri, zonja Ministre, me vetëdije të plotë është: kontratën e sponsorizimit me nr. prot 3216, datë 27.08.2020, “Tashko & Pustina”, kush e ka zgjedhur, e zgjedhët ju, e zgjedhi fondacioni? Si ishte procedura? Pse kjo studio, jo një studio tjetër? U bë një tender? Çfarë ndodhi, për hir të transparencës?

Zonja Ministre, pranuat këtu se do të jepni me koncesion vetëm zonën A, atë që prodhon të ardhura, për këtë, sigurisht, fshihni edhe planin e biznesit të të ardhurave dhe nuk e vini në dispozicion as të deputetëve dhe jo më të publikut, i cili ka shumë të drejta, sepse flitet për identitetin kombëtar, për trashëgiminë kulturore, për pasurinë kombëtare. Vazhdoni ta mbani sekret.

Zonja Ministre, AADF-ja ka qenë partneri juaj, partneri shqiptar, jo juaji personalisht, për ligjin “ Për trashëgiminë kulturore”, për ndryshimet që i hapën rrugë edhe këtij koncesioni, dhënies së Butrintit te privati. AADF-ja ka bërë planin e menaxhimit të integruar që parashikon ta marrë një fondacion. AADF-ja, po, është vetë fondacioni. Çdo jurist sadopak, edhe baçelor të jetë, e kupton që këtu: ka një konflikt interesi, që vetë bëjmë ligjin, vetë bëjmë planin dhe vetë e marrim apo jo? Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, në këtë rast çdo fondacion jo vetëm ky i Butrintit, sepse ju parashikoni të jepni gjithë pasurinë kombëtare shqiptare me koncesion, ta marrë ofertuesi i parë, ai që shpreh interes, parashikon, zonja Ministre që ministria, në fakt ju, nuk ndërhyri dhe u lini fondacioneve të gjitha kompetencat për menaxhimin e tyre financiar. VKM-ja nr. 625, që të jem korrekte, datë 04.09.2019, në pikën 4 të saj thuhet që ju i garantoni, ministria, jo ju, sepse ju jeni e përkohshme, por ministria si institucion i garanton që ata të bëjnë menaxhimin efektiv të parasë, që do të thotë që parane fondacioni mund ta përdorë si e mendon vetë që është më efektive. Ajo që juve ju duket e çuditshme, benzat, biletat e avionit kanë ndodhur me para publike në një komision tjetër hetimor, nuk varet nga ju.

Përderisa ju u jepni me VKM mundësinë që të menaxhojnë parane e shqiptarëve, atëherë menaxhimin e dinë ata dhe ju këtu nuk mund të mohoni apo të pohoni diçka që nuk e dini se si do të ndodhë.

Zonja Ministre,

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju do të shtyni votimin, jo diskutimin. Unë nuk kam të drejtë vote, por nuk mora përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zonja Ministre, dy pyetje thelbësore, se mos i harroni, po jua përsëris, sepse ndoshta i harroni.

1. Ekspertët shqiptarë janë të papërfshirë në planin e menaxhimit të integruar të Butrintit; asnjë ekspert shqiptar.

2. Plani i parasë, plani i biznesit që ju trajtoni Butrintin është i fshehur dhe i patrajtuar për të dhënë mundësi që të abuzohet; protokollin i bashkëpunimit është i fshehur dhe i papublikuar; kontrata e sponsorizimit me studion Tashko & Pustina”, mënyrat e zgjedhjes, pse është zgjedhur ajo dhe roli janë të papublikuara. Sigurisht, si do të jetë ky fondacion, cili është fondacioni, themeluesit. Në VKM thuhet që themeluesit e fondacionit kanë të drejtë të caktohen përfaqësuesit e tyre në bordin e drejtorëve. Ta dimë se cilët janë themeluesit, janë emrat? Prandaj, informacioni është shumë i rëndësishëm dhe shpresoj që kësaj radhe të mos

kemi atë mediokritetin e përgjigjeve shabllon, sepse nuk kemi mundësi të marrim përgjigje për publikun.

Tritan Shehu – Unë nuk do të hyj në diskutim për çështjen, sepse e thashë se do të përgatitem herën tjetër.

Të falënderoj, kryetar, që more në konsideratë *gentlemen agreement* që bëra me Pandin, gjë që më bëri të ndërroj mendimin, të them të drejtën, të vë në dyshim një thënie të Çerçillit, i cili ka thënë: “Mos i besoni asnjëherë *gentlemen agreement* me të majtët, por gjithmonë kini kujdes në ecjen me ta”. Megjithatë, sot shkoi mirë, shyqyr.

Entela Çipa – Faleminderit, kryetar!

Dëshiroj t’i sqaroj të gjithë deputetët, sepse ky diskutim u hap që dje. Nga një diskutim me administratën e Kuvendit janë mbajtur jo të publikuara dokumentacioni i fondacionit dhe plani i biznesit, për shkak se përmbajnë të dhëna të personave të tjerë që nuk janë persona publikë. Megjithatë, ne kemi marrë konsensusin dhe do të publikohen. Ndërkohë, mundet që të jenë publikuar të gjitha: plani i biznesit, aktet e themelimi, megjithëse ka edhe të dhëna të njerëzve jopublikë. Ky ishte sqarimi. Të gjitha tashmë do të jenë publike.

Blendi Klosi – Faleminderit, sekretare!

Shumë mirë që gjërat diskutohen me qetësi dhe gjithsecili merr kohën e vet. Ja ku u sqaruan, të paktën kolegët nuk kanë më tani asnjë ndjesi se është një gjë e fshehtë: o bobo se çfarë do të ndodhë! Pastaj për të gjykuar për gjënë, është diçka tjetër, por asgjë të fshehtë nuk ka në këtë histori.

Fjala për ministren për të mbyllur procesin e diskutimit.

Elva Margariti – Edhe një herë nuk ka asnjë element jotransparent dhe aq më tepër sekret apo sekret shtetëror në këtë marrëveshje. Po të kishim pasur mundësinë, kohën dhe mirëkuptimin, në komisionin e djeshëm do ta kishim shtruar po njësoj të gjithë këtë arsyetim. Nuk e patët mundësinë dje, e kemi sot. Prandaj jemi vërtet të kënaqur që edhe zonja Zhupa pa një shembull qytetarie në sallën e Kuvendit.

Analiza e bërë për planin e biznesit, dhe dua t’i kthehem pak zotit Alizoti, me të drejtë nuk është as propagandë politike dhe as fjalë trumbetuese, histori sukcesi, por janë numra. Fati i mirë është që plani i biznesit flet me numra. Numrat nuk janë të interpretueshëm. Nëse ju do të keni dëshirën dhe kohën, ju bëj një përmbledhje shumë të shkurtër tani, siç u vendos dhe në komision, jemi shumë të gatshëm që në takimin e radhës të kemi diskutime të tjera dhe votimin.

Unë do të ndalesha shumë shkurt në një përmbledhje të planit voluminoz: investimet e reja janë në totalin prej 7,52 milionë dollarësh në 7 vjet operim. Punimet në konservimin e sitit i përmenda në relacionin tim, janë 2.93 milionë dollarë. Qendra e re e vizitorëve parashikohet, për sa kohë që nuk ka një projekt të detajuar, 2,88 milionë dollarë. Hyrja e re në sit, zyrat e stafit, rrethimi i sigurisë, shtigjet e reja, pra këtu fillojmë dhe dalim jashtë zonës arkeologjike, janë 300 mijë dollarë. Shërbimi i ri muzeal në kalanë veneciane, në kullën veneciane parashikohet rreth 600 mijë dollarë; interpretimi i ri në fortesën trekëndore dhe në mbarë sitin është 325 mijë dollarë. Flasin për interpretimin nëpërmjet teknologjive të reja për turizmin kulturo. Mjete transporti për vizitorët dhe rojtarët, si: varka, automjet, autobusë, nuk kemi cituar marka benzi, janë 493 mijë dollarë. Shpenzimet në total parashikohen prej 11, 49 milionë dollarësh në 7 vjet operim, ku shpenzimet operationale, mendohet të jenë 9,3 milionë dollarë, studime, konsulenca të specializuara 1, 27 milionë dollarë. Rikthehemi këtu në pjesën arkeologjike. Grupi kërkimor i Butrintit 540 mijë dollarë, kontributi në projekte të tjera kombëtare të trashëgimisë kulturore është 380 mijë dollarë.

Të ardhurat nga operimi i sitit janë 15,95 milionë dollarë në 7 vjet operim; të ardhura të parashikuara nga biletat hyrëse 14, 4 milionë dollarë, të ardhura të tjera si donacione, operimi i varkave, shitje me pakicë 1,55 milionë dollarë; financimi i themeluesve, është financim nga AADF-ja, 4,99, e kemi rumbullakosur dhe kontributi i qeverisë shqiptare, kasa aktuale e Butrintit, 2,1 milionë dollarë. Besoj se këto janë të rëndësishme dhe auditit i llogarive të fonacionit do të bëhet nga një nga “*Big four*”, siç është praktika e auditit të shtetit.

Plani i biznesit është hartuar, siç thashë, me konsulentët e shoqërisë të specializuar angleze “*Prince&Pearce*”, në bashkëpunim me *University College of London* dhe me Qendrën Arkeologjike. Plani i menaxhimit ka kaluar në të gjithë konsultimin publik në të gjitha instancat edhe të Institutit të Arkeologjisë. Po e ripërsëris, për ne dhe jo vetëm, por për të gjithë shtetin shqiptar, përfaqësia më e lartë e ekspertëve lokalë është përfaqësia e Institutit të Arkeologjisë, ata janë instituti i specializuar i kësaj fushe dhe ekspertët kanë dhënë rekomandimet e tyre, janë konsultuar, kanë qenë pjesë e të gjitha tryezave të planit të menaxhimit të integruar.

Për sa i përket planit të menaxhimit aktual, shifrat që kanë dalë, që lidhen totalisht me ekspertët lokalë, vijnë edhe si pjesë e integruar e protokollit të bashkëpunimit midis fondacionit dhe Institutit të Arkeologjisë. Pra, do të ketë një mbështetje financiare për institutin dhe projektet e hulumtimeve arkeologjike. Jemi duke u dhënë patjetër në këtë lloj mënyre prioritet arkeologëve shqiptarë.

Më lini të them edhe këtë, ndoshta zonjës Zhupa, do t'i interesojë fondacioni do të sigurojë edhe ambiente të përshtatshme për arkeologët dhe do të kontribuojë në krijimin e një ambienti të ri në Sarandë për depozitimin e fondit arkeologjik.

E kemi aktualisht një fond arkeologjik në zonën e Butrintit, është zonë e mbyllur, kemi parashikuar nëpërmjet këtij fondacioni që të krijojmë kontribute të tjera shtesë për të krijuar një muze të ri në qytetin e Sarandës.

Me këtë lajm të mirë, uroj për zonjën Zhupa, që do t'u shtojë banorëve të Sarandës edhe një tjetër aset jo vetëm në Butrint, dua t'ju falënderuar të gjithëve për mirëkuptimin dhe për qytetarinë e këtij komisioni. Edhe njëherë do ta përsëris se nuk kemi asgjë për të mos e shprehur me transparencë, aq më tepër sekrete!

Blendi Klosi – Atëherë, kolegë deputetë, duke mbyllur këtë fazë të diskutimit parlamentar në komisionin tonë të projektligjit “ Për administrimin e marrëveshjes së administrimit në zonat e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për menaxhimin e Butrintit”, falënderoj të gjithë kolegët deputetë, pa dyshim ministren dhe stafin e saj, zëvendësministren e Turizmit gjithashtu! Falënderoj shumë relatorët për paraqitjen dinjitoze të këtij projektligji dhe kolegët për të gjitha diskutimet!

Procesin e fundit, në vendimmarrjen e këtij komisioni, votimin e këtij projektligji do ta shtyjmë për një moment tjetër, në mbledhjen e ardhshme të komisionit, pasi kolegët të jenë të informuar tashmë edhe nga uebsajti i ministrisë për të gjitha materialet që kishin mungesë në informacion.

Besoj të shkojmë në mbledhjen e ardhshme të komisionit me një votim sa më të shpejtë. Do të kërkoja shumë të kishim dakordësi, por, edhe nëse nuk do të ketë një dakordësi, kjo nuk do të përbëjë laj. E rëndësishme është që ne diskutuam dhe pranuar që çdo gjë është transparente dhe në të mirën e Butrintit në radhë të parë dhe të ekonomisë shqiptare po ashtu.

Shumë faleminderit, zonja Ministre!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

Pastaj vazhdojmë me diskutimin e zotit Shehu. Meqenëse kemi një rend dite, të mos e ndryshojmë rendin e ditës, doktor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'ju humbasë dhe ju informacioni, është *live*. Nëse doni ta bëni publik qëndrimin tuaj, pa dyshim keni hapësirën tuaj.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tritan Shehu – Sot është data 27 prill. Të them të drejtën, është përvjetori i masakrës së madhe të Mejës afër Gjakovës së Kosovës, ku u vranë në një ditë 377 burra dhe fëmijë nga paraushtarakët dhe nga forcat serbe, masakër, e cila u parapri dhe u pasua dhe nga masakra të tjera, të kryera nga forcat serbe në Kosovë, e cila në tërësinë e saj përbën një gjenocid ndaj popullsisë së Kosovës. Ashtu siç e ka thënë edhe Komisioneri për Marrëdhëniet me Jashtë i BE-së, siç ia tha edhe para disa ditëve Kryeministres së Serbisë, nëse nuk kërkohet falje për krimet, absolutisht ato nuk mund të skanohen.

Në këto kushte, unë kam paraqitur një kërkesë zyrtare, ia kam dorëzuar sot Kryetares së Kuvendit, ku kërkoj që nesër parlamenti shqiptar të mbajë një minutë heshtje solemne në kujtim dhe nderim të viktimave, por dhe për dënimin e gjenocidit serb mbi popullin e Kosovës.

Në ditët që vazhdojnë, do të kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve, do të ndërmarr edhe hapat formalë për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë, në rajon dhe në Srebrenicë, siç e ka bërë edhe parlamenti i Kosovës, siç ka bërë edhe parlamenti i Malit të Zi, siç kanë bërë edhe parlamente të tjera.

Unë ju ftoj të bashkohemi të gjithë në këtë iniciativë, edhe pse është një iniciativë që ka të bëjë jo vetëm thjesht me kujtimin, por me dënimin e krimeve. Nëse nuk dënohen krimet, nuk mund të ecet përpara. Prandaj, në këtë drejtim kam një komunikim me mediet pas pak minutave për këtë çështje. Pres edhe gjykimin e Kryetares së Kuvendit, sepse është kompetencë e saj, në bazë të nenit 7, pika 5, të Rregullores të vendosë për mbajtjen e heshtjes solemne në seancë plenare. Kam paraqitur materialin sipas të gjitha kërkesave të Rregullores për këtë gjë dhe shpresoj që të gjithë bashkë të procedojmë në këtë mënyrë, veçanërisht ne si Komisioni i Jashtëm, për të dalë me një rezolutë, më tej për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë, e theksoj, në rajon në vazhdimësi. Por ne jemi më të interesuar dhe të ndjeshëm për Kosovën.

Faleminderit!

Blendi Klosi – Faleminderit, koleg!

Pa dyshim qëndrimi juaj do të jetë në seancën plenare dhe procedurat ju do t'i ndiqni tashmë publike, pastaj në linjën parlamentare. Asnjë koment, pa dyshim për ato që thatë. Është gjithçka në vlerësimin tuaj dhe pastaj parlamenti do të vendosë në seancë nesër.

Shumë faleminderit, kolegë!

E deklaroj mbledhjen e mbyllur!

MBYLLET MBLEDHJA